



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 60001-00313-00-2023 Regj. Themeltar
Nr.00-2023- 1001 i Vendimit**

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga:

Ilir PANDA	-Kryesues
Albana BOKSI	-Anëtare
Medi BICI	-Anëtar

sot, më datë 15.06.2022 mori në shqyrtim, në dhomë këshillimi, çështjen penale me nr. 60001-00313-00-2023 akti që ju përket palëve :

KËRKUESE: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Palë e interesuar: Marina Bay Saranda SHPK

OBJEKTI: Caktimin e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro preventive”, për pasurinë me nr. 696, me emërtimin “Baza Ndihmuese”, Limion, Sarandë, regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, me nr. 1/416, ndodhur në zona kadastrale 8642, volumi 30, faqe 158.

BAZA LIGJORE: Nenet 274 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjo i relatimin e gjyqtarit Ilir Panda dhe e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjatë gjykimit të çështjes, gjykatat e faktit kanë evidentuar se Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në fazën e hetimit paraprak, në kuadër të procedimit penal të regjistruar më datë 16.04.2021, me nr. 108, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (KP), ka kërkuar caktimin

e masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventive” për pasurinë nr. 696, me sipërfaqe 39.446 (tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e dyzet e gjashtë) m², me emërtimin “Baza Ndihmuese” Limion, Sarandë, regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, me nr. 1/416, Zona Kadastrale 8642, Volumi 30, Faqe 158.

2. Ky procedim penal është regjistruar mbi bazë të kallëzimit të shtetasit Artur Meçollari, me detyrë Kapiteni i Rangut të Parë ish-Zv. Komandant i Shtabit të Forcës Detare, depozituar më datë 29.3.2021. Sipas kallëzimit dhe akteve bashkëngjitur (korrespondenca me Komisionerin për të Drejtën e Informimit, Kontratë qiraje nr. rep. 982, nr. kol. 445, datë 16.7.2020; Projektvendimi i VKM nr. 514, datë 1.7.2020, i shoqëruar me relacion dhe Gen-Plan; prononcimi përfundimtar dërguar Shtabit të Përgjithshëm që përfshin pronën nr. 696 në Planin e Përhapjes dhe Vendosjes, Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm), kanë shkelur ligjin, në lidhje me dhënien me qira të pasurisë Gjiri i Limionit, Sarandë, me nr. 696 pasurie, pronë e cila është në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe brenda të cilës ndodhet baza ndihmuese e forcës detare, duke qenë pjesë e Planit të Përhapjes dhe Vendosjes të miratuar nga Presidenti i Republikës, pasi nuk janë përmbushur të gjitha hapat e duhur ligjor për disponimin e saj me Vendim të Këshillit të Ministrave (më poshtë referuar VKM) nr. 514, datë 1.7.2020. Gjithashtu, ushtrimi i ndjekjes penale është kërkuar edhe për Komisionerin për të Drejtën e Informimit, në raport me korrespondencën e mbajtur nga kallëzuesi me këtë institucion në kuadër të kërkesave të lidhura me marrjen e akteve mbi procedurën, e cila më pas është kallëzuar prej tij.

3. Në vijim, më datë 08.08.2022, kallëzuesi ka paraqitur shtesë kallëzimi penal, në kuadër të hetimeve mbi procedimin penal tashmë të regjistruar më datë 16.04.2021, me nr. 108, për veprën “Shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i KP.

4. Ka rezultuar se Prokuroria e Posaçme, me shkresën nr. 10074 prot., datë 9.12.2021, ka kërkuar informacion pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, në lidhje me statusin e pronës me nr. 696, identifikuar si “Baza Ndihmuese”, Limion, Sarandë, lidhur me sipërfaqen e saj, nëse kjo pronë është në plan-përhapje dhe vendosje, si dhe praktikën shkresore të ndjekur për dhënien me qira të kësaj prone kompanisë private “Marina Bay Saranda” SHPK.

5. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, me shkresën nr. 8530/3 prot., datë 28.12.2021, ka përcjellë informacionin e marrë nga Komanda e Forcës Detare (më poshtë referuar si KFD) në lidhje me statusin e pronës, duke informuar/njoftuar se prona nr. 696, “Baza Ndihmuese” Limion, Sarandë, me sipërfaqe 39.446 m² është përfshirë në plan-përhapje dhe vendosje të Forcës Detare, miratuar me Dekret të Presidentit të Republikës nr. 8593, datë 17.6.2014.

6. Në këtë praktikë është dhe praktika e përcjellë nga Ministria e Mbrojtjes tek Drejtoria e Miradministrimit të Pronave dhe Aseteve në varësi të saj. Komanda e Forcës Detare, me shkresën me nr. 223/1 prot., datë 21.1.2020, i kthen përgjigje Drejtorit të Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, mbi shkresën e tyre për dhënie mendimi për projekt vendimin për miratimin e kontratës së koncesionit të Portit Turistik dhe Shërbimeve “Marina Limion”. Komanda e Forcës Detare, në shkresën adresuar Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, ka shprehur mendimin në lidhje me projekt vendimin për miratimin e Kontratës së Koncesionit Partneritet Publik Privat, për dhënien me koncesion të Portit Turistik dhe shërbimeve “Marina Limion, si më poshtë: “... *Relacioni i paraqitur nuk prezanton asnjë planvendosje mbi projektin, specifikon sipërfaqen në të cilat prona përfshihet, por jo se kush institucion i ka në administrim ato etj. Ai jep një pamje të përgjithshme mbi projektin dhe shoqërohet nga një skemë, ku lihet qarte të kuptohet se projekti Marina Limion, do të shtrihet në portin aktual në administrim i Port Saranda SHA dhe në pronën 696 “Baza ndihmuese Sarandë ne administrim të Forcë Detare”. Kjo gjë*

evidentohet dhe ne raport ku përcaktohet se projekti do të ketë si gjatësi bankine 1790 ml, kur në fakt porti i Sarandës ka vetëm 70 ml. Po ashtu, përfshirja e dy dallgëthyesve, një në lindje dhe një në perëndim, është tregues që Marina Limion shtrihet edhe në pronën 696 “Baza ndihmuese Sarandë Limion” në administrim të Forcës Detare. Në relacion gjendet vetëm një skice treguese, e cila përfshin brenda saj pronën 696 “Bazën ndihmuese” Sarandë me sipërfaqe 39446 m² dhe në PVP të FD-së. Relacioni nuk sqaron se si e ka përfshire pronën 696 “Bazën ndihmuese Sarandë” në administrim të FD. Relacioni nuk sqaron se si e ka përfshirë pronën 696 “Bazën ndihmuese Sarandë”, në administrim të FD në projekt dhe cilën procedurë ligjore ka ndjekur. Komanda e Forcës Detare me shkresën nr. 106/1, datë 02.12.2019 të klasifikuar), ka dërguar SHPFA konceptin e planit të vendosjes dhe përhapjes (PVP) të Forcës Detare, ku për Bazën Ndhmuese Sarandë jemi shprehur të qëndrojmë brenda (PVP). Projekti i prezantuar përfshin jo vetëm hapësirën portuale dhe tokësore në inventar të MIE, por edhe të gjithë hapësirën e Bazës Ndhmuese Sarandë, aktualisht në PVP. Baza ndihmuese e Sarandës i ka shërbyer Forcës Detare dhe Rojës Bregdetare për përmbushjen e misionit të tyre qysh nga viti 1974. Kjo nevojë buron nga misioni i Forcës Detare/Rojës Bregdetare dhe koncepti operacional i FD, i cili parashikon shpërndarjen operacionale të mjeteve përgjatë bregdetit, për përmbushjen e misionit të Rojës Bregdetare (zbatimi i ligjit dhe SAR në det), si dhe ushtrimin e sovranitetit të Shtetit Shqiptar në hapësirën detare. Mungesa e një baze detare në rajonin e Kanalit të Korfuzit, një rajon detar me trafik të shtuar ndërkombëtar, cenon kërkesat operacionale të Forcës Detare/Rojës Bregdetare për përgjigje në kohe, shpejtësi dhe intensitetin e parashikuar nga ky koncept.

Komisioni i ngritur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, gjatë studimit të propozimit ka vlerësuar dhe shprehur qëndrimin se ky propozim vjen në përputhje me interesin publik. Komisioni i ngritur nga MIE, sipas relacionit ka vlerësuar interesin publik në terma të zhvillimit ekonomik dhe financiar, por nuk ka argumentuar në asnjë pikë nëse ky interes është në përputhje me interesat kombëtare të Shtetit Shqiptar për ushtrimin e sovranitetit, për zbatimin e ligjshmërisë dhe kërkim/shpëtimin në det në hapësirën kombëtare dhe atë të interesit të detyrueshme nga marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura nga Shteti Shqiptar. Mbrojtja e interesave kombëtare të Shtetit Shqiptar nga kërcënimet dhe rreziqet e hapësirës detare kombëtare është interes publik i rëndësishëm. Projekti i propozuar cenon ndjeshëm kapacitetet operacionale dhe, rrjedhimisht, edhe zbatimin e misionit të forcës detare dhe roje bregdetare.

Komisioni i miratimit të projektit Marina Limion në MIE ka kapërcyer kompetencat në miratimin e projektit, duke përfshirë brenda tij edhe pronën nr. 696 “Baza Ndhmuese Sarandë”, në administrim të Forcës Detare. Kjo pronë është në planin e vendosjes dhe përhapjes se FD-së dhe i shërben operacionalitetit dhe misionit të Forcës Detare dhe Rojës Bregdetare. Pronat në planin e vendosjes dhe përhapjes të FA-së, trajtohen në përputhje me procedurat e parashikuara nga ligji nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e te komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Mbështetur për sa argumentuam, kryesisht cenimin e ndjeshëm të kapaciteteve operacionale dhe, rrjedhimisht, edhe misionin e Forcës Detare dhe Rojës Bregdetare, Komanda e Forcës Detare nuk shprehet dakord për miratimin e këtij projektvendimi.”.

7. Pjesë e praktikës së përcjellë me shkresën nr. 8530/3 prot., datë 28.12.2021, të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm është dhe shkresa e Komandës së Forcës Detare me nr. 231/1 prot., date 22.1.2020 (në përgjigje të shkresës nr. 227/1 prot., date 20.1.2020). Sipas kësaj shkrese. Komanda e Forcës Detare nuk është dakord për miratimin e këtij projektvendimi, sepse nga sipërfaqja e pasqyruar nga përshkrimi i projektit dhe skema në relacion nuk përputhen me sipërfaqen nën administrim të Portit Sarandë, pasi krijon

mbivendosje me pronën 696 “Baza ndihmuese Sarandë”, në administrim të FD dhe në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes.

8. Me shkresën nr. 10883/8, datë 11.6.2020, te Ministrisë së Financave, drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes sipas të cilës, rezulton se MFE dërgon për shqyrtim kërkesën e datës 11.06.2020 të shoqërisë “Concord Investment” SHPK dhe “Kastrati Group” SHA, me lëndë “Marrje me qira të pasurisë shtetërore për destinacion turizmin me ofertë të pakërkuar, ndodhur në Gjirin e Limionit, Sarandë, me qëllim të marrjes së kësaj pasurie, në fushën e turizmit. Pasuria, e cila kërkohet të merret me qira pjesërisht, është në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe, për këtë arsye, i kërkon të shprehen, nëse ka interes për ta dhënë me qira dhe, nëse po, të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm, ndër të cilat kërkohet edhe miratimi i organit të varësisë administrative.

9. Pas marrjes nga Ministria e Financave të kërkesës së datës 11.06.2020 të shoqërisë “Concord Investment” SHPK dhe “Kastrati Group” SHA, me lëndë “Marrje me qira të pasurisë shtetërore për destinacion turizmin me ofertë të pakërkuar, në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes, kanë vijuar këto procedura:

10. Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me shkresën nr. 2649/2, datë 16.6.2020, i drejtohet Shtabit të Përgjithshëm dhe Komandës së Forcës Detare dhe kërkon identifikim dhe prononcim në lidhje me kërkesën për marrjen me qira nga ofertuesi.

11. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, me shkresën nr. 3099/1, datë 17.06.2020, i kërkon Komandës së Forcës Detare të prononcohet në lidhje me kërkesën për dhënien me qira. Kjo e fundit, me shkresën nr. 1721/7 prot., datë 17.6.2020, informon se: në Gjirin e Limionit ka tre prona, prona nr. 696 (brenda PVP), prona 1171 (jashtë PVP), si dhe prona 1172 (jashtë PVP). Duke marrë në konsideratë kohën e pamjaftueshme në dispozicion që na lejon urdhri juaj verbal për kthim përgjigje brenda datës 17 Qershor 2020, lidhur me përdorimin e saj në të ardhmen, KFD ka shprehur qëndrimin e saj në shkresat e mëparshme. Referimi në qëndrimin dhe shkresat e mëparshme përkon me shkresën nr. 223/1 prot., datë 21.1.2020 dhe nr. 231/1, datë 22.1.2020, nga të cilat Komanda nuk jep dakordësi për projektin e Koncesionit/Partneritet Publik Privat.

12. Megjithëse është administruar shkresa nr. 1721/7 prot., datë 17.6.2020 e Komandës së Forcës Detare, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, me një shkresë tjetër, një ditë më vonë sesa data e shkresës së përgjigjes së Komandës së Forcës Detare, më datë 18.6.2020 përpilon shkresën nr. 3192 prot., “Kërkesë për prononcim”, drejtuar Komandës së Forcës Detare, në përmbajtje të së cilës shprehet se në shkresën me nr. 1721, datë 17.6.2020 të saj, me objekt “Kthim Përgjigje”, nuk del qartë prononcimi i Komandës (për disa çështje), nëse pronat e kërkuara bëjnë pjesë në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes, konfirmimin e operacionalitetit dhe nëse duhet te jepet me qira apo jo.

13. Komanda e Forcës Detare me shkresën nr. 1762/3 prot., datë 18.6.2020, i kthen përgjigje Shtabit të Përgjithshëm, duke vënë në dijeni dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Ekonomisë dhe Shërbimeve Mbështetëse, ku ndër të tjera informon se: *“Forca Detare është dakord me propozimin e investitorit strategjik, i cili për moscenimin e aspekteve operationale të FA merr përsipër “pro buono” ndërtimin përkundrejt pagesës pa kosto për shtetin të një banking të ne për ankorimin e anijeve të FA dhe ambienteve të tjera mbështetëse në ndihmë të saj, sipas nevojave tuaja. Duke marrë në konsideratë përse më lart mbas vlerësimit të bërë në FD, gjykojmë se pozicioni më i mirë i ndërtimit të bazës do të ishte në pjesën jugore të kepit perëndimor të Gjirit të Limionit. Për të përmbushur qëllimet dhe funksionin e saj, do të duhet që baza e re të ndërtohet në një sipërfaqe 7000-9000 m², të ketë një bankinë rreth 130 ml dhe të ketë infrastrukturën e nevojshme. Forca detare shprehet parimisht dakord për dhënien me qira të pjesës së ngelur jashtë hapësirës mbi të cilën do të*

shtrihet projekti i Bazës së re Ndhmuese të Limionit ...”, duke parashtruar dhe kërkesat e përgjithshme, teknike dhe procedurale.

14. Rezulton se shkresa nr. 1762/3 prot., datë 18.6.2020, e Komandës së Forcës Detare, pra përgjigja për Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, është paraprirë nga shkresa nr. 1762/1 prot., datë 18.6.2020, me objekt “Urdhër nr. 205, datë 18.06.2020, “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e shkresës së Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA. nr. 3192, datë 18.6.2020, “Kërkesë për prononcim”, me të cilën është ngritur grupi i punës i përbërë nga Sabri Gjinollari me detyrë Shef Shtabi në FD, Engjëll Sinanaj me detyrë Shef Dege në N3/7 në FD, Dritan Seraj me detyrë Zv/Komandant i Flotiljes Detare dhe Denis Madhi, jurist në FD. Del se qëllim i krijimit të këtij grupi është vlerësimi dhe analizimi i kërkesave sipas shkresës nr. 3192 prot., datë 18.6.2020, të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

15. Me shkresën nr. 1762/2 prot., datë 18.06.2020 grupi i punës ka përpiluar informacion drejtuar Zv/Komandantit të Forcave Detare, duke përcaktuar hollësisht kërkesat për misionin e bazës së Forcës detare në Gjirin e Limionit, veprimtaritë ekonomike, konceptin e shpërndarjes operationale të Forcës detare dhe ristrukturimin e bazave. Gjithashtu, në studimin e kryer nga grupi i punës, identifikohen katër variante të ripozicionimit të bazës ndihmuese duke krahasuar avantazhet dhe disavantazhet për secilin variant, duke arritur në konkluzionin se varianti i tretë është varianti më i mirë, varianti i dytë është i pranueshëm, varianti katërt është më pak i pranueshëm dhe varianti i parë është i papranueshëm. Identifikimi i këtyre varianteve, shoqërohet edhe me kërkesat teknike për rindërtimin e bazës ndihmuese siç janë: *“te gjendet në ekstrem të kepit perëndimor të gjirit të Limionit, të ketë sipërfaqe midis 7000 dhe 9000 m², bankine 130 metra linear ose 90+40 ml, të ketë akses të lirë nga trafiku rrugor dhe të jetë element fundor i trafikut dhe jo tranzitor në baze”*.

16. Me shkresën nr. 2649/2 prot., datë 16.6.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve pranë Ministrisë së Mbrojtjes, drejtuar Shtabit të Përgjithshëm, ky i fundit, pasi administron Memon e Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes, i kthen përgjigje si më poshtë: *“Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura në bashkëpunim me Forcën Detare ka bërë identifikimin e pasurive që kërkohen nga MFE për marrjen me qira të pasurisë shtetërore në Gjirin e Limionit Sarandë, nga Shoqëritë Concord Investment SHPK dhe Kastrati Group SHA. Pasuritë që kërkohen të merren me qira i përkasin pronave me nr. 696 me emërtim Bazë ndihmuese, prona me nr. 1271 me emërtim objekt të bazës ndihmuese, si dhe prona me nr. 1272 me emërtim Objekte të bazës ndihmuese. Prona me nr. 696 bën pjesë në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes të FARSH, ndërsa pronat me nr. 1271 dhe 1272 nuk bëjnë pjesë në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes të FA. Gjithashtu, Shtabi i Përgjithshëm i FA shprehet parimisht dakord me kërkesën e ardhur nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë....pasi ruhet gatishmëria dhe operacionaliteti nëpërmjet ndërtimit të një bankine të re dhe infrastrukturës mbështetëse të saj, sipas standardeve të kërkuara, duke zbatuar të gjitha aktet ligjore e nënligjore dhe administrative në fuqi. Të dhënat teknike që ruajnë operacionalitetin e FA-se për ndërtimin e bankinës së re dhe infrastrukturës mbështetëse të pronës brenda planit të përhapjes, jemi të gatshëm t'i negociojmë në fazën e hartimit të kontratës.”*.

17. Në vijim, me shkresën nr. 3202 prot., datë 18.6.2020, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i përcjell Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve pranë Ministrisë së Mbrojtjes prononcimin e KFD-së të mbërritur me shkresë nr. 1762/3 prot., datë 18.6.2020, ku rezulton i njëjti mendim që KFD i ka dërguar edhe drejtpërdrejtë Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

18. Prokuroria e Posaçme, me shkresën nr. 10074 prot., datë 09.12.2021, i ka kërkuar Ministrisë së Mbrojtjes, dokumentacionin në lidhje me çështjen dhe kjo e fundit, me shkresën nr. 6248/2 prot., datë 11.01.2022, përcjell të njëjtin dokumentacion, sikurse dhe nga Shtabi Përgjithshëm, të cituar më lart.

19. Më datë 12.04.2022, është këqyrur dokumentacioni në Ministrinë e Mbrojtjes në lidhje me dhënien me qira nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të pronës nr. 696 në administrim nga Forca Detare në Gjirin e Limionit, si dhe dhënia me Koncesion/Partnerit Publik Privat, të portit turistik nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës, duke përfshirë nga shkresa “Përcjellje kontratë qiraje” nr. 3378/8 prot., datë 14.8.2020, “Memo” nr. 3378/5 prot., datë 13.8.2020.

20. Rezulton, gjithashtu, se me procesverbalin e datës 13.04.2022, është këqyrur dokumentacioni në lidhje me dhënien me qira nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të pronës nr. 696 në administrim nga Forca Detare në Gjirin e Limionit, si dhe dhënia me Koncesion/Partneritet Publik Privat të portit turistik nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës, duke përfshirë: “Kërkesë për marrje me qira të pronës shtetërore” datë 11.6.2020; “Kërkesë për prononcim” nr. 10883/1 prot., datë 11.06.2020, duke përfshirë dhe akte që kanë të bëjnë me fazën e zbatimit të kontratës së qirasë, datë 16.07.2020, midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Concord Investment dhe Kastrati Group SHA. Në këtë praktikë evidentohet akti “Urdhër nr. 473, datë 7.4.2021, për ngritjen e grupit të punës për Hartimin e Projektit të Ndërtimit të Bankinës së Re dhe Infrastrukturës Mbështetëse të saj, në Pronën në Administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, me Emërtimin “Gjiri i Limionit”, Sarandë, në zbatim të kontratës së qirasë me çmimin simbolik 1 (një) Euro/Kontrata, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 01.07.2020. Ndër të tjera, në Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes, në pikën 7 citohet se dorëzimi përfundimtar i pronës te kryhet pas realizimit të projektit të ndërtimit të bankinës së re dhe infrastrukturës mbështetëse nga qiramarrësi sipas akt-marrëveshjes së arritur me Forcën Detare.

21. Me shkresën nr. 2, datë 7.5.2021 të dërguar nga kompania “Marina Bay Saranda”, mbërrin në Komandën e Forcës Detare një propozim për ambientet e Forcës Detare dhe, me konkretisht, kompania e sipërcituar i propozon Forcës Detare ndërtimin e:- Depo Armatimi 150 m²; ambiente funksionale 450 m²; ambient parkimi dhe depozitë karburanti 6000 m²; kalatë për ankorimin e 2 mjeteve lundruese nga 20 ml sipas skicës; një post ankorimi për anije deri në 90 ml sipas nevojës.

22. Komanda e Forcës Detare, më datë 02.08.2021, me shkresën nr. 2825 prot., miraton propozimin e administratorëve Genard Kastrati dhe Viron Hamzai për ndërtimin e objekteve dhe përcaktimin e sipërfaqeve funksionale në interes të KFD dhe më datë 10.12.2021 me dokumentin nr. 4389 prot., është lidhur një “Akt-Marrëveshje me kompaninë “Marina Bay Saranda për dhënien e aksesit për fillimin e punimeve për ndërtimin e objekteve në interes të komandës së forcës detare dhe lejimin për kalimin e mjeteve dhe të personelit që do të punojnë për ndërtimin e dallgëthyesit në pronat në administrim të komandës së forcës detare. Gjiri i Limionit, Sarandë”.

23. Me procesverbalin nr. 875/2 regj., datë 30.3.2022 dhe nr. 10 regj., datë 29.3.2022, Komisioni i ngritur me urdhër të Komandës së Forcës Detare nr. 90, datë 12.3.2022, “Për krijimin e komisionit për dorëzimin e pronës nr. 696 (Baza ndihmuese), pronës nr.1271 (objekte të bazës ndihmuese) dhe pronës nr. 1272 (objekte të bazës ndihmuese), Gjiri i Limionit, Sarandë, në prani të administratorëve të shoqërisë Marina Bay Saranda SHPK, dorëzon pronat në administrim.

24. Komandanti i Forcës Detare me shkresën nr. 875/3 prot., datë 4.4.2022, pas dorëzimit të pronave, i dërgon informacion Ministrit të Financave dhe Ekonomisë mbi dorëzimin e pronave në administrim të forcave detare, në Gjirin e Limionit, Sarandë.

25. Duke qenë se prona nr. 696 është e vendosur në plan vendosje dhe përhapje, është kërkuar gjatë hetimit paraprak dhe informacion pranë Shtabit të Përgjithshëm në lidhje me komunikimin e mbajtur me Presidentin e Republikës. Me shkresën nr. 1138/1 prot., datë 12.5.2022, Shtabi i Përgjithshëm përcjell në Prokurorinë e Posaçme komunikimin shkresor me Presidentin e Republikës së Shqipërisë (drejtuar më datë 2.2.2021 me nr. 79/1 prot. dhe nr. 319 prot., datë 31.3.2021 dhe nr. 698/1 prot., datë 29.7.2021) në përmbajtje të të cilës, sqaron se: *“Vendbazimi Detar, me vendndodhje Limion, Sarandë (prona me nr. 696). Me VKM nr. 514, date 01.07.2020, pjesërisht i është dhënë me qira shoqërisë tregtare “Marina Bay Saranda” SHPK (përfaqësuar nga Genard Kastrati dhe z. Viron Hamzai). Për të ruajtur aktivitetin dhe mos cenuar operacionalitetin e strukturës së Forcës Detare shoqëria “Marina Bay Saranda”, ka marrë përsipër ndërtimin e një bankine rëre dhe infrastrukturën mbështetëse të saj sipas standardeve të kërkuara nga Komanda e Forcës Detare. Aktualisht, prona nuk është dorëzuar deri në saktësimin, garantimin dhe përmbushjen e detyrimeve të shoqërisë tregtare “Marina Bay Saranda” SHPK, sipas kërkesave të bëra nga Komanda e Forcës Detare.... Si dhe: Dhënia në përdorim apo qira e pronave brenda PVP është bërë në bazë të akteve ligjore dhe n/ligjore në fuqi, për të cilën Ju kemi informuar në informacionin nr. 319, date 31.03.2021. Pronat e dhëna me qira dhe përdorim nuk kanë dalë nga PVP, të cilat do të mbeten në të ardhmen si asete të Forcave të Armatosura Lidhur me pronën nr. 696, “Vendbazimi Detar, me vendndodhje Limion Sarandë ne zbatim te VKM-se nr. 514, date 01.07.2020” dhe me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 473, datë 7.4.2021, është ngritur grupi i punës, i kryesuar nga Komandanti i Forcës Detare, me qëllim hartimin e projektit përfundimtar për ndërtimin e bankinës së re dhe infrastrukturës mbështetëse në pronën 696, për t’u bërë pjesë e kontratës ekzistuese me subjektin qiramarrës. Dorëzimi i pronës nuk është bërë ende, pasi do të kryhet pas realizimit të projektit ndërtimit të bankës së re dhe infrastrukturës mbështetëse nga qiramarrësi, sipas akt marrëveshjes të lidhur me Forcën Detare. Me ndërtimin e bankinës dhe infrastrukturës ndihmuese sipas kërkesës operationale të Forcës Detare, shprehur edhe në prononcimin e Asaj Force, nuk cenohet operacionaliteti i FD.”.*

26. Me shkresën nr. 424 prot., datë 10.05.2022, Presidenti i Republikës informon se: *“Me Dekret 8539, datë 17.6.2014, te Presidentit të Republikës “Për miratimin e Planit të Vendosjes dhe Përhapjes së Forcave të Armatosura te Republikës së Shqipërisë” ne zbatim të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e te komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është miratuar plani i vendosjes dhe përhapjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në këtë Dekret, në pikën 4.5. “Oficina e Fara Fenerëve në nën pikën 4.5.37, renditet posaçërisht “Limion Djabat, Sarandë” ndërsa në nënpikën 4.5.38, renditet “Limion Majtas, Sarandë”, që përkojnë pikërisht me pronën objekt i hetimit tuaj pranë Institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, nuk është depozituar asnjë dokument shkresor (kërkese/relacion) nga Ministria e Mbrojtjes, për nxjerrjen jashtë planit të vendosjes dhe përhapjes të Forcave të Armatosura. Deri në këtë moment prona me nr. 696, baza sipërcituar, është sipas legjislacionit në fuqi, brenda planit të vendosjes dhe përhapjes së Forcave të Armatosura. Institucioni i Presidentit, pas marrjes se informacionit për miratimin e vendimit nr. 514, datë 1.7.2020, të Këshillit të Ministrave ne lidhje me këtë prone, me kërkesën me nr. 29/3 prot., datë 23.6.2021, në mënyrë të përsëritur i ka kërkuar Ministrit të Mbrojtjes informacion të hollësishëm posaçërisht për pronat brenda planit të vendosjes dhe përhapjes, dhënë në përdorim, qira apo enfitëozë, pa marrë më parë miratimin me Dekret të posaçëm nga Presidenti i Republikës në cilësinë e Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, siç edhe ligjit. ligji nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e te komandimit të Forcave te Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, e përcakton në nenin 9, pika 3, shkronja f..”.*

27. Me procesverbalin e datës 13.4.2022, janë marrë aktet që i përkasin zbatimit të kontratës datë 16.7.2020, marrëveshjet midis palëve, ku konstatohet se nga ana e autoriteteve shtetërore janë pranuar propozimet e investitorit, edhe pse fillimisht investitori merrte përsipër përmbushjen e projektit sipas propozimit të organit që administron pronën. Prokuroria e Posaçme ka analizuar se, me propozimin e ri të investitorit, konstatohet ndryshim thelbësor i projektit që ka shërbyer si bazë për daljen e VKM nr. 514/2020, si në sipërfaqe ashtu dhe në vëllim të punimeve. Arsyetohet, gjithashtu se, në çdo komunikim dhe akt shkresor nga palët theksohet se çdo ndërhyrje duhet të ruajë operacionalitetin dhe gatishmërinë e Forcës Detare, duke nënkuptuar se ky funksion i lihet në dorë investitorit dhe se ky i fundit ka autoritetin për të ruajtur operacionalitetin dhe gatishmërinë e Forcës Detare, në një kohë që ky funksion është detyrues për Komandën.

28. Në datat 6.4.2022 dhe 7.4.2022 janë pyetur në cilësinë e personave që kanë dijeni, disa nga zyrtarët e përfshirë në procesin e dhënies me qira të kësaj prone, të cilët deri në këtë moment kanë qenë përfaqësues të Forcave të Armatosura në kohën e lidhjes së kontratës së qirasë.

29. Në lidhje me procedurën e koncesionit, gjatë hetimeve paraprake veprimet hetimore dhe qëndrimi i Prokurorisë së Posaçme konsiston si në vijim:

30. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në janar të vitit 2020, me shkresën nr. 402 prot., datë 13.1.2020, i drejtohet Ministrisë së Mbrojtjes duke kërkuar mendim/të shprehur mbi dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privat të Portit Turistik, Sarandë, Bashkimit të Operatorëve “Kastrati Group” dhe “Edil-al” SHPK, për arsye se në datë 2.9.2019, ora 14:00, ofertuesi, Bashkimi i Operatorëve “Kastrati Group” dhe “Edil-al” SHPK (koncesionari), ka paraqitur propozimin e tij në lidhje me procedurën konkurruese “Oferta e koncesionarit”, e pranuar nga Autoriteti Kontraktues (komisioni i dhënies me koncesion) dhe Autoriteti Kontraktues, me shkresën nr. 8507 prot., datë 10.10.2019, i ka dërguar koncesionarit “Njoftimin e fituesit”, nëpërmjet të cilës është ftuar ofertuesi fitues (koncesionari) për negocimin e kontratës koncesionare.

31. Ministria e Mbrojtjes, me shkresën nr. 227/1 prot., datë 20.1.2020, përmendur edhe më lart, i drejtohet Komandës së Forcës Detare, Drejtorisë së Miradministrimit të Pronave dhe Aseteve, si dhe Shtabit të Përgjithshëm, e cila me shkresën nr. 227/2 prot., datë 21.1.2020 kthen përgjigje se nuk është kompetente për t’u shprehur për këtë procedurë, duke qenë se ajo si drejtori, shqyrton vetëm procedurat e transferimit, privatizimit dhe qiradhënies së pronave dhe jo të procedurave të prokurimit siç është koncesioni.

32. Komanda e Forcës Detare, me shkresën nr. 231/1 prot., datë 22.01.2020, përmendur edhe më lart, shprehet se Komanda e Forcës Detare nuk është dakord për miratimin e këtij projektvendimi, pasi sipërfaqja e pasqyruar nga përshkrimi i projektit dhe skema në relacion nuk përputhen me sipërfaqen nën administrim të Portit Sarandë pasi krijon mbivendosje me pronën nr. 696 “Baza ndihmuese Sarandë”, në administrim të FD dhe në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes.

33. Drejtori i Shtabit të Përgjithshëm me shkresën nr. 462 prot, datë 22.01.2020, ka shprehur mosdakordësinë e tij për miratimin e projektit, pasi ky i fundit do të përfshinte edhe pronën nr. 696, e cila është në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes, duke cenuar ndjeshëm kapacitetet operationale dhe, rrjedhimisht, edhe zbatimin e misionit të Forcës Detare dhe Rojës Bregdetare.

34. Si pasojë e këtij komunikimi, Ministri i Mbrojtjes nëpërmjet shkresës nr. 227/6 prot., datë 30.01.2020, i drejtuar Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë (më poshtë referuar si MIE) shpreh mosdakordësinë për miratimin e projektit duke arsyetuar se: “... është i pamundur identifikimi i pronave në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes që preken nga projekti, pasi të dhënat tekniko-ligjore, përfshirë dokumentacionin teknik që

shoqërojnë projektvendimin janë të paplota. Gjithashtu kanë bërë me dije se në vendndodhjen e projektit. Ministria e Mbrojtjes ka në përgjegjësi administrimi katër prona, një pjesë e të cilave janë brenda Planit të Vendosjes dhe Përhapjes së Forcave të Armatosura, miratuar me Dekretin e Presidentit nr. 8593, datë 17.6.2014...”

35. Me shkresën nr. 402/8 prot., datë 28.5.2020, MIE përsërit kërkesën dhe i kërkon mendim Ministrisë së Mbrojtjes mbi një projektvendim, të dhënies me Koncesion/Partneritet Publik Privat të portit turistik Sarandë, duke i bashkangjitur kërkesës edhe një hartë të detajuar të zonës ku do të shtrihet koncesioni.

36. Ministria e Mbrojtjes në vijim të kësaj shkrese i kërkon mendim (nëpërmjet shkresës nr. 1964/4 prot., datë 18.06.2020, të përpiluar nga Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore), vetëm Drejtorisë së Miradministrimit të Pronave dhe Aseteve, si dhe Shtabit të Përgjithshëm, duke anashkaluar Komandën e Forcës Detare që e kishte në administrim pronën, ku dhe do të shtrihet projekti i Portit të Ri Turistik në Sarandë. Referuar projektit të dorëzuar projektvendimi përfshin edhe pronën nr. 696 “Baza Ndihmuese” Limion, Sarandë.

37. Në ndryshim nga komunikimi shkresor i mëparshëm (shkresa nr. 227/2 prot., datë 21.1.2020, paragrafi 20 i këtij vendimi) që kishte dhënë Drejtoria e Miradministrimit të Pronave dhe Aseteve, ku shprehej jo kompetente për të trajtuar pronat e dhëna me koncesion, nëpërmjet shkresës nr. 1969/5 prot., datë 18.06.2020 shprehet: “... Ne zonën e Limionit. Ministria e Mbrojtjes ka në administrim 4 prona. Përsa i përket operacionalitetit dhe gatishmërisë lutemi të merret mendimi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ...”.

38. Shtabi i Përgjithshëm (pa ngritur një grup pune për t’u shprehur mbi cenimin e operacionalitetit dhe gatishmërisë të FA nga shtrirja e Projektit të Portit të Ri), nëpërmjet shkresës nr. 3201 prot., datë 18.6.2020 sqaron se: “Shtabi i Përgjithshëm i FA-se vlerëson dhe thekson se çdo ndërtim/investim që do të bëhet nga koncesionari në portin turistik dhe të shërbimeve (Marina Limion) të mos cenojë operacionalitetin, sigurinë dhe gatishmërinë e Forcave të Armatosura/Forcave Detare, si dhe ushtrimin e sovranitetit dhe zbatimin e ligjshmërisë në det...”.

39. Ministri i Mbrojtjes, po ashtu me shkresën nr. 1969/8 prot., datë 18.06.2020, i dërgon Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dakordësinë për zhvillimin e projekt-vendimit për dhënien me koncesion/partneritet publik privat, të portit turistik dhe të shërbimeve Sarandë, me rekomandimin që ndërtimi i tij “te mos cenoje operacionalitetin, sigurinë dhe gatishmërinë e Forcave të Armatosura/Forcave Detare, si dhe ushtrimin e sovranitetit dhe zbatimin e ligjshmërisë në det”.

40. Në përfundim të këtij procesi, është hartuar dhe miratuar VKM nr. 515, datë 1.7.2020, “Për miratimin e Kontratës së Koncesionit Partneritet Publik Privat, për dhënien me koncesion partneritet publik privat të Portit Turistik dhe të Shërbimeve Marina Limion, ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik Kastrati Group SHA dhe Edil-Al-It SHPK”. Prokuroria e Posaçme ka analizuar se është disponuar me një kontratë koncesioni mbi një pronë të vendosur në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes, të miratuar me Dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, pronë e cila shërben për ruajtjen e sigurisë kombëtare dhe se, nga korrespondenca e kryer me Presidentin e Republikës, por dhe nga tërësia e akteve të administruara, nuk ka asnjë komunikim me këtë institucion në lidhje me pronën nr. 696, pronë e cila sipas Dekretit nr. 8539, datë 17.6.2014, bën pjesë në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes. Përfshirja e kësaj prone me status të veçantë, pasi përbën bazë ushtarake, ku funksioni primar i saj është ruajtja e sigurisë kombëtare, në VKM-në për dhënien me koncesion të Portit Turistik është në kundërshtim edhe me parashikimin e nenit 6 të ligjit nr.

125/2013 “Për Koncesionet”: “Ky ligj nuk zbatohet për koncesionet/partneritetet publike private, në rastet e mëposhtme: b) kur realizimi i tyre duhet të shoqërohet me masa të veçanta të sigurisë, në përputhje me ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative në fuqi apo kur një gjë e tillë kërkohet nga mbrojtja e interesave thelbësorë të shtetit.

41. Në vijim është arsyetuar se disponimi i kësaj prone, duke e përfshirë në kontratën e koncesionit të miratuar me VKM nr. 515, të vitit 2020, tek subjekte privatë, në një kohë që prona e vendosur në Plan Përhapje dhe Vendosje i shërben mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, vë në rrezik sigurinë kombëtare dhe detyrimet që shteti shqiptar ka ndaj NATO apo organizmave të tjerë ndërkombëtar. Siç vetë VKM-ja nr. 628, datë 25.09.2019, “Për miratimin e dokumentit të rishikimit të strategjisë të mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë”, parashikon: *“RSM përshkruan interesat strategjike kombëtare dhe politikat e mbrojtjes së RSH, trajton rëndësinë dhe koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të sigurisë, evidenton sasinë dhe cilësinë e kapaciteteve që duhet të disponojnë Forcat e Armatosura të RSH, sipas skenarëve të mundshëm të përdorimit të tyre, nëpërmjet argumentimit analitik të rolit të tyre në mjedisin e ri të sigurisë, për të bërë të mundur funksionimin si një forcë e mirëpajisur e mirëtrajnuar dhe e aftë profesionalisht për të realizuar misionin kushtetues ... Mjedi kombëtar i sigurisë është nën një presion të vazhdueshëm të kërcënimeve komplekse, shumëdimensionale dhe subjekt i ndryshimeve të papritura. Këto kërcënime dhe rreziqe, në mënyrë të paparashikuar, po ndryshojnë ndjeshëm natyrën, intensitetin dhe ndikimin ndaj sigurisë globale...Si vend anëtar i NATO dhe kontribues për paqen dhe sigurinë globale, Republika e Shqipërisë është e ekspozuar ndaj terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm, kërcënimit konvencional, kibernetik dhe hibrid, të cilat, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, kërcënojnë sigurinë kombëtare ...”*.

42. Në lidhje me procedurën e dhënies me qira, gjatë hetimeve paraprake veprimet hetimore dhe qëndrimi i Prokurorisë së Posaçme konsiston si në vijim:

43. Më datë 11.06.2020 Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën me nr. 10883/8, përcjell në Ministrinë e Mbrojtjes dhe i kërkon asaj prononcim për një projekt-vendim, pasi ky organ ka marrë një ofertë të pakërkuar nga një bashkim operatorësh “Kastrati Group” SHA dhe “Concord Investment” SHPK për marrjen me qira me tarifën simbolike 1 euro të pronave në Gjirin e Limionit për ndërtimin e një projekti turistik. Më konkretisht, kërkohet dhënia me qira e disa pronave në përgjegjësi administrative të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Investitori shprehet i gatshëm për mos cenimin e aspekteve operacionale të Forcave të Armatosura dhe merr përsipër *“pro buono”* ndërtimin përkundrejt pagesës pa kosto për shtetin të një bankine të re për ankorimin e anijeve të Forcave të Armatosura dhe ambienteve të tjera mbështetëse në ndihmë të saj, sipas nevojave të Forcës Detare.

44. Në këtë shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkohet që, nëse Ministria e Mbrojtjes ka interes, duhet të përgatisë dokumentacionin e duhur, duke përfshirë dhe “Miratimin e organit të varësisë administrative” pra, të Komandës së Forcës Detare (KFD). Gjithashtu, krahas dokumentacioni të kërkuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë kërkon edhe të saktësohet dhe konfirmohet, nëse kjo pasuri është jashtë Planit të Forcave të Armatosura. Ministria e Mbrojtjes nëpërmjet Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Ekonomisë dhe Shërbimeve Mbështetëse me shkresat përkatësisht nr. 3099/1 prot., datë 17.06.2020 dhe nr. 2649/2 prot., datë 16.06.2020, me objekt “Kërkesë për prononcim”, i kërkojnë Komandës së Forcës Detare të prononcohet.

45. Komanda e Forcës Detare, me shkresën nr. 1721/7 prot., datë 17.6.2020, i përgjigjet se në Gjirin e Limionit ka tre prona, prona nr. 696 (në plan vendosje dhe përhapje), prona 1171, si dhe prona 1172 (jashtë planit vendosjes dhe përhapjes). Duke marrë ne

konsideratë kohën e pamjaftueshme në dispozicion që na lejon urdhri juaj verbal për kthim përgjigje brenda datës 17 Qershor 2020, lidhur me përdorimin e saj në të ardhmen, KFD ka shprehur qëndrimin e saj në shkresat e mëparshme.”. Sikurse u relatua edhe më lart, referimi në qëndrimin dhe shkresat e mëparshme përkon me shkresën nr. 223/1 prot., datë 21.01.2020 dhe nr. 231/1, datë 22.1.2020, nga të cilat Komanda nuk jep dakordësi për projektin e Koncesionit/Partneritet Publik Privat dhe që u përshkruan më lart.

46. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, me shkresën nr. 3192 prot., datë 18.6.2020, i dërgon një tjetër “Kërkesë për prononcim” Forcës Detare, pasi duhej saktësuar, nëse prona ishte në Plan Vendosi dhe Përhapje, nëse cenohej operacionaliteti i saj, si dhe nëse duhej dhënë me qira.

47. Komanda e Forcës Detare me anë të shkresës nr. 1762/3 prot., datë 18.6.2020, i përgjigjet ndër të tjera: “... Forca detare është dakord me propozimin e investitorit strategjik i cili për mos cenimin e aspekteve operationale të FA merr përsiper “pro buono” ndërtimin përkundrejt pagesës pa kosto për shtetin të një bankine të re për ankorimin e anijeve të FA dhe ambienteve të tjera mbështetëse në ndihme të saj, sipas nevojave tuaja. Duke marrë në konsideratë sa më lart, mbas vlerësimit të bërë në FD, gjykojmë se pozicioni më i mirë i ndërtimit të bazës do të ishte në pjesën jugore të kepit perëndimor të Gjirit të Limionit. Për të përmbushur qëllimet dhe funksionin e saj, do të duhet që baza e re të ndërtohet në një sipërfaqe 7000-9000 m², të ketë një bankine rreth 130 ml dhe të ketë infrastrukturën e nevojshme. Forca detare shprehet parimisht dakord për dhënien me qira të pjesës së ngelur jashtë hapësirës mbi të cilën do të shtrihet projekti i Bazës së re Ndihmuese të Limionit ...”. Siç është përmendur më lart, në pjesën e akteve të administruara, bashkëngjitur kësaj shkrese, Komanda e Forcës Detare ka përcjellë aktet e përpiluara për dhënien e këtij prononcimi që janë urdhrin për ngritjen e grupit të punës, të cilët nga ana e tyre kanë përgatitur informacion në lidhje me objektin e kërkesës së MFE, duke përcaktuar në mënyrë të hollësishme Kërkesat e Përgjithshme, Kërkesat Teknike dhe Kërkesat Procedurale për nevojat e FD mbi Bazën e Re Ndihmuese.

48. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, me shkresën nr. 3099/3 prot., më datë 17.06.2020, i ka kthyer përgjigje shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike nr. 2649/2 prot., datë 16.6.2020, të DPESHM (edhe pse nuk e kishte të qartë prononcimin e Forcës Detare, nëse shprehej dakord apo jo për dhënien me qira të pronave në Gjirin e Limionit, qëndrim që Forcat Detare e shpreh një ditë më pas në shkresën nr. 3192 prot., datë 18.06.2020) shpreh dakordësinë mbi kërkesën e ardhur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për marrjen me qira të disa pasurive shtetërore me vendndodhje Limion, Sarandë, në administrim të Forcës Detare, pasi dhënia me qira e sipërfaqeve të këtyre pronave nuk cenon operacionalitetin e FARSH/Forcës Detare pasi ruhet gatishmëria dhe operacional nëpërmjet ndërtimit të një bankine e re dhe infrastrukturës mbështetëse të saj, sipas standardeve të kërkuara duke zbatuar të gritha aktet ligjore dhe ligjore dhe administrative në fuqi ...

49. Nisur pikërisht nga ky komunikim zyrtar me shkresë, shkresa e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm me nr. 3099/3, datë 17.06.2020, nisur në Ministri përpara se të administrohet përgjigja e Komandës së Forcës Detare, pra, pa e patur të qartë nëse ky organ jep dakordësinë e tij, organ i cili në këndvështrim të ligjit është organi që ka në varësi administrative, pikërisht pronën nr. 696, e cila ndodhet në Plan Vendosi dhe Përhapje dhe që ushtron aktivitetin e tij operacional. Pra, arsyetohet nga prokuroria se jepet dakordësia nga ana e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, për të dhënë pronën nr. 696 me qira, para se të merret mendimi i plotë i Komandës së Forcës Detare.

50. Ndërkohë, me shkresën nr. 3202 prot., datë 18.06.2020, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, sikurse u relatua edhe më lart, i përcjell DPESHM-së prononcimin e Forcës

Detare me shkresën nr. 1762/3 prot., datë 18.06.2020, praktike e cila shpreh dakordësinë e saj për dhënien me qira te pjesës së mbetur jashtë projektit mbi të cilin duhet të ndërtohet baza e re ndihmuese në Limion Sarandë (prononcimin e KFD): “... Për të përmbushur qëllimet dhe funksionin e saj, do të duhet që baza e re të ndërtohet në një sipërfaqe 7000-9000 m², të ketë një bankinë rreth 130 ml dhe ketë infrastrukturën e nevojshme Forca detare shprehet parimisht dakord për dhënien me qira të pjesës së ngelur jashtë hapësirës mbi të cilën do të shtrihet projekti i Bazës së re Ndihmuese të Limionit ...”.

51. Bazuar në këtë praktikë, me shkresën nr. 2649/8 prot., datë 18.6.2020, Ministri i Mbrojtjes i kthen përgjigje Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke i shprehur dakordësinë për kryerjen e investimit në Gjirin e Limionit, pasi ka marrë dakordësinë nga strukturat në varësi të saj (duke i bashkangjitur kësaj shkrese dy prononcimet e bëra respektivisht nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura nëpërmjet shkresës nr. 3167 prot., datë 17.6.2020 dhe Komanda e Forcës Detare nëpërmjet shkresës nr. 1762/3 prot., datë 18.06.2020).

52. Nga aktet e zbatimit të kontratës të lidhur në vijim të VKM-së nr. 514, datë 1.7.2020, në ndryshim me sa ishte parashikuar në kontratë, në pikën 5.8 të saj, qiramarrësi në funksion të zhvillimit të aktivitetit dhe sipas kushteve të propozuara nga Ministria e Mbrojtjes dhe të marra përsipër nga qiramarrësi, duhet të ruhet gatishmëria dhe operacionaliteti nëpërmjet ndërtimit të një bankine të re dhe infrastrukture mbështetëse të saj sipas standardeve të kërkuara. Ndërkohë, arsyetohet nga Prokuroria se gjatë zbatimit Ministria e Mbrojtjes nuk ka paraqitur ndonjë standard tjetër veç projektit të propozuar me Informacionin e Grupit të Punës, të ngritur më datë 17.6.2020 nga Komandanti i Forcës Detare, në prononcimin e dhënë për dhënien me qira, madje, është investitori që propozon një projekt të ri, i cili redukton parashikimet e identifikuar nga Grupi i Punës pranë KFD, si në shtrirje dhe në vëllim të punimeve. Gjithashtu, arsyetohet se krijohet bindja që nevojat e operacionalitetit dhe gatishmërisë së Komandës përcaktohen nga investitori (privati).

53. Më datë 1.7.2020, është miratuar VKM nr. 514, “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 Euro/Kontrata ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënëse, dhe Bashkimit të Shoqërive “Concord Investment” SHPK dhe “Kastrati Group SHA, si qiramarrës, për Pasurinë Shtetërore, Gjiri i Limionit, Sarandë, me sipërfaqe të përgjithshme 265299,5 m², në Përgjegjësi Administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”. Në vijim, më datë 16.7.2020 është lidhur kontrata e qirasë me çmim simbolik 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe shoqërisë tregtare “Marina BAY SARANDA SHPK”, duke u përfshirë edhe prona nr. 696 “Baza ndihmuese” Limion. Sarandë, prej 39446 m², e përfshirë në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes, sipas Dekretit nr. 8539, datë 17.6.2014, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

54. Në vijim, në mbështetje të kërkesës për vendosjen e masës së sekuestros preventive, arsyetohet, ndër të tjera, se: “Për këtë pronë organi që kishte varësinë e drejtpërdrejtë administrative, Komanda e Forcës Detare, ishte prononcuar se dakordësinë e saj e jepte përtej sipërfaqes prej 7000-9000 m², hapësirë të cilën kjo forcë, e konsideronte të nevojshme të qëndronte në planin e vendosjes dhe përhapjes, e rrjedhimisht të pacenueshme për shkak të operacionalitetit dhe gatishmërisë që duhej të ruante Komanda e Forcës Detare, në këtë territor. Krijohet dyshimi se, nuk janë ndjekur hapat procedurale të detyrueshëm të parashikuar nga ligji nr. 64/2014, pasi në mënyrë që të jepej me qira, një pronë e vendosur në plan vendosje dhe përhapje të forcave të armatosura, duhej të nxirrej nga plani, e për këtë arsye do të duhej të bëheshin ndryshime në Dekretin e Presidentit që ka miratuar planin e vendosjes dhe përhapjes, në fuqi që nga viti 2014 ... duke iu kthyer dhe shkeljeve ligjore që dyshohen të jenë kryer, Ministri i Mbrojtjes, do të duhej t’i propozonte Presidentit të

Republikës së Shqipërisë ndryshimet e pronës të vendosur në Planin e Vendosies dhe Përhapjes, pasi një pronë e vendosur në të, nuk është thjesht një pasuri shtetërore, siç përcakton pika 2 e VKM nr. 54/2014 (sipas të cilit pasuri shtetërore janë ndërtesat, sipërfaqet funksionale (jo nën ndërtesë), truall i lirë, makineritë e pajisjet e linja e prodhimit të institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare me kapital 100 % shtetërore (në vijim shoqëri shtetërore) dhe tokat e pafrytshme), por prona e vendosur në Plan Vendosije dhe Përhapje ka aktivitet operacional për misionet e kërkim shpëtimit, apo të rojës bregdetare, veprime këto që i shërbejnë sigurisë kombëtare të një vendi, një pronë e tillë siguron ruajtjen, gatishmërinë dhe operacionalitetin e njësie apo reparteve të dislokuara në këto prona. Në këtë kuptim, edhe pse KFD, ka propozuar dhe është prononcuar pro dhënies me qira, gjithsesi, ka kërkuar që pjesa prej 7000-9000 ku do të vendosej Baza e Komandës, edhe pse ajo do të rinovohej, nuk duhej të jepet me qira, mendim ky i komandës që nuk është konsideruar nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe Ministri i Mbrojtjes, të cilët prononcimin e dhënë nga KFD, e kanë përcjellë si një dakordësi për dhënien me qira të gjithë pronës së vendosur në Planin Vendosies dhe Përhapjes, pra në tërësi të pronës me nr. 696, “Baza ndihmuese”, Limion, Sarandë”, prej 39446 m², pronë e cila është dhënë e gjitha me qira subjektit tregtar.”.

55. Në vijim arsyetohet se, edhe gjatë zbatimit të kontratës së lidhur më datë 16.7.2020, për një afat 20 vjeçar, midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe shoqërisë tregtare “Marina Bay Saranda” konstatohet se nuk është marrë në konsideratë nevoja e Komandës së Forcës Detare, pasi projekti i propozuar nga kjo Forcë, është reduktuar në vëllim dhe në shtrirje duke lënë disponim të lirë të investitorit mbi pronën që në fakt është bazë ushtarake. Kontrata e koncesionit e miratuar me VKM nr. 515, datë 1.7.2020, dyshohet se është lidhur në kundërshtim me ligjin, *së pari*, pasi është disponuar mbi një pronë, destinacioni i së cilës është përcaktuar me Dekret të Presidentit të Republikës dhe ajo është e vendosur në Planin e vendosjes dhe Përhapjes dhe, si e tillë, nuk mund të disponohet lirisht nga subjekte private; e dyta organi në varësi dhe që ka autoritetin e drejtimit dhe të kontrollit (Komanda e Forcës Detare) nuk ka dhënë pëlqimin e tij për t’u dhënë në koncesion pjesa që i përket pronës nr. 696 e quajtur “Baza Ndihmuese Limion, Sarandë”, pikërisht, për shkak të rolit të saj si garantuese e mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe, *së treti*, edhe vetë ligji “Për koncesionet” (nr. 125/2014) e përjashton mundësinë e dhënies me koncesion në rastet e parashikuara nga neni 6, shkronja “b” dhe “gj”, e tij, të sipërcituara më lart.

56. Kontrata e dhënies me Koncesion/PPP nëpërmjet VKM nr. 515, datë 1.7.2020, si Kontrata e dhënies me qira nëpërmjet VKM nr. 514, datë 1.7.2020 janë disponuar mbi disa prona në administrim të Forcës Detare dhe, me konkretisht, duke përfshirë edhe pronën nr. 696, në Gjirin e Limionit, e cila sipas Dekretit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë është e përfshirë në Planin e Vendosies dhe Përhapjes. Kjo e cilëson këtë pronë në veçanti me një karakter të veçantë, për shkak se në atë pronë duhet të ruhet gatishmëria dhe operacionaliteti nga ana e Forcës Detare dhe Rojës Bregdetare. Për shkak të pozicionit gjeografik të kësaj prone, ajo cilësohet një pronë aktive në sigurinë detare dhe kombëtare...”.

57. Në përfundim, është konkluduar se gjatë analizimit të dokumentacionit të këqyrrur dyshohet për disa veprime të kryera nga zyrtarët e lartë të Forcave të Armatosura dhe zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, në kundërshtim me ligjin dhe me aktet nënligjore në praktikën e dhënies me qira apo dhënien me koncesion të pronës nr. 696 të njohur si “Baza ndihmuese” Limion, Sarandë, pronë e cila, me Dekret të Presidentit të Republikës, është në Plan Vendosije dhe Përhapje. Është arsyetuar se ekziston rreziku që disponimi i lirë i pasurisë së paluajtshme mundet të lehtësojë ose të zgjasë pasojat e veprës penale apo të lehtësojnë kryerjen e veprave të tjera penale dhe se duhet të ndërpriten kryerja e veprimeve të investimit në fushën e turizmit apo dhe ndërtime të tjera nga investitori mbi pronën nr. 696.

58. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 91, datë 24.2.2023, ka vendosur: “1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. 2. Caktimin e masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventive” për pasurinë nr. 696, me sipërfaqe 39 446 (tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e dyzetë e gjashtë) m², me emërtimin “Baza Ndihmuese Limion, Sarandë, regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, me nr. 1/416, Zona Kadastrale 8642, Volumi 30, Faqe 158. 3. Për administrimin e pasurisë ngarkohet administratori Skënder Met’hasani, administrator në Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në Ministrinë e Brendshme, Tiranë. Për ekzekutimin e masës së sigurimit pasuror, ngarkohet policia gjyqësore e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Tirane dhe Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në Ministrinë e Brendshme. 5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 10 (dhjetë) ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi Prokurorisë ose nga dita që i interesuari ka marrë dijeni për sekuestron e vënë.”.

59. Kjo gjykatë, ndër të tjera, ka vlerësuar se kërkesa e Prokurorisë së Posaçme është e bazuar në ligj dhe në prova për arsye se, bazuar në parashikimet e nenit 274, të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe të nenit 248 të KP, së pari gjykata çmon se në ngarkim të të dyshuarve, të këtij procedimi penal, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se është konsumuar elementi i veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar neni 248 të Kodit Penal. Së dyti, Gjykata çmon gjithashtu se ekziston rreziku se disponimi i lirë i pasurisë së sipërcituar mund të lehtësojë apo të zgjasë pasojat e veprës penale apo të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale. Vendosja e masës së sekuestrimit parandalon rrezikun që pasuria të mund të lehtësojë apo të zgjasë pasojat e veprës penale, parandalon rrezikun e shitjes, së tjetërsimit apo humbjes se pasurisë që mund të konfiskohet. Ndaj duhet të ndërpritet kryerja e veprimeve të investimit në fushën e turizmit apo edhe ndërtime të tjera nga investitori pasi cenohet gatishmëria dhe operacionaliteti i KFD, pikërisht mbi pronën nr. 696, e vendosur në Plan Vendosje dhe Përhapje, duke vënë në rrezik sigurinë kombëtare.

60. Në lidhje me administrimin e pasurisë së sekuestruar, në bazë të neneve 4 dhe 11, të ligjit nr. 34, të vitit 2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” (ligji nr. 34/2019), rezulton se me vendimin e sekuestrës, gjykata është e detyruar të caktojë një administrator për pasurinë e sekuestruar mbështetur në listën e ekspertëve të Agjencisë së Administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

61. Gjithashtu, në bazë të nenin 16 të ligjit nr. 34/2019, rezulton se me ekzekutimin vendimit të gjykatës për sekuestron preventive ngarkohet policia gjyqësore dhe administratori, ku ky i fundit kur masa e sekuestrimit caktohet ndaj pasurisë së regjistruar njoftojnë menjëherë këtë masë në zyrat pranë të cilave mbahen këto regjistra si: regjistri tregtar, Agjencia Shtetërore e Kasadastrës, organe tatimore etj.. Të drejtë, gjykata çmon parashtrimin e prokurorit se duhet të ndërpritet kryerja e veprimeve të investimit në fushën e turizmit apo dhe ndërtime të tjera nga investitori, mbi pronën nr. 696, për arsye se disponimi lirisht i kësaj prone nga subjektet private cenon gatishmërinë dhe operacionalitetin e Forcës Detare, operacionaliteti i cili duhet të vazhdojë të kryhet nga organi kompetent që është Komanda e Forcës Detare, pa ndërhyrje të subjekteve private.

62. **Kundër** këtij vendimi ka paraqitur apel pala e interesuar Marina Bay Saranda SHPK, duke kërkuar nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që në bazë të nenit 276, të KPP, të vendosë shfuqizimin e vendimit nr. 91, datë 24.2.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe masës së sekuestrës preventive të caktuar prej saj.

63. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 9, datë 3.4.2023, ka vendosur: “1. Ndreqjen e gabimit material në pikën 2 të dispozitivit të vendimit nr. 91, datë 24.2.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar përsa i përket përbërësit “faqe të regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, të pasurisë mbi të cilën është caktuar masa e sekuestrimit, duke u lexuar nga “faqe 158” në “faqe 157”. 2. Miratimin e vendimit nr. 91, datë 24.2.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.”.

64. Kjo gjykatë, ndër të tjera, ka arsyetuar se, fillimisht, konstatohet që lidhur me ankimin ndaj vendimit të vënies ose jo të sekuestrës preventive, referenca bëhet në nenin 276 të KPP, “Ankimi kundër vendimit”, duke marrë shkak nga pretendimi i ngritur nga prokurorja e posaçme në seancë gjyqësore, pretendim sipas të cilit pala ankuese “Marina Bay Saranda” SHPK nuk legjitimohet për të paraqitur ankim, meqenëse prona fillimisht i përket shtetit dhe organeve që e administrojnë atë dhe se janë ato që duhet të paraqesin ankim dhe jo pala qiramarrëse, ky koleg j gjen me vend të ndalet në interpretimin e togfjalëshit të pikës 1 të nenit 276 të KPP: “cilido që ka interes mund të bëjë ankim”. Jo pa qëllim ligjvënësi nuk e ka lidhur të drejtën e ankimit ndaj vendimit të sekuestrës preventive me faktin se ankuesi duhet të ketë patjetër të drejtën e pronësisë mbi sendin e sekuestruar, por ka përdorur një koncept më të gjerë, koncept që përfshin cilindo që gëzon të drejta reale, detyrimi apo personale karshi sendit. Pra, e drejta e ankimit iu njihet atyre personave që konsiderohen mbajtës të një interesi konkret dhe aktual, sikurse rezultojnë në rastin konkret të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë ankuese “Marina Bay Saranda” SHPK, të buruara nga kontrata e qirasë së lidhur ndërmjet asaj si palë qiramarrëse dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si palë qiradhënëse e pasurisë shtetërore (arsyetuar po kështu në aktin “apel” nga pala ankuese). Gjithashtu, ligjvënësi ka pasur parasysh edhe faktin se, nëpërmjet sekuestrës preventive, kur plotësohen kërkesat ligjore për vendosjen e saj, mund të sekuestrohet edhe prona e cila nuk i përket pronarit, pra, i përket një personi tjetër, që gjithsesi gëzon “interes konkret dhe aktual mbi këtë pronë, interes mbi të cilin po ky subjekt legjitimohet në kuadër të garantimit të së drejtës së ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka vendosur masën e sigurimit pasuror të sekuestrës preventive. Duke marrë në konsideratë rrethanat e fakteve sikurse më lart, ky koleg vlerëson se pala ankuese “Marina Bay Saranda” SHPK legjitimohet për të ushtruar apel ndaj vendimit nr. 91, datë 24.2.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në kuptim të nenit 420, pika 1, shkronja “b” të KPP. Nga ana tjetër, vështrohet që akti “apel” është paraqitur i nënshkruar nga administratorët e dy shoqërive tregtare që kanë krijuar Bashkim Operatorësh (palë që më tej rezultojnë qiramarrëse e pasurisë shtetërore), si dhe nga përfaqësuesi me prokurë i shoqërisë, avokati Dorian Çeliku. Në tërësi, përveç faktit që ankimi është bërë nga ai që është i legjitimuar”; “ndaj një vendimi që është i ankimueshëm” dhe “brenda afatit ligjor të ankimit” (shkronjat “a”; “b” dhe “e”, të pikës 1 të nenit 420 të KPP). Gjykata e Posaçme e Apelit konstaton se nuk ka as shkaqe të tjera nga ato të parashikuara nga neni 420, pika 1 i KPP (kur është hequr dorë nga ankimi gjatë gjykimit dhe kur ankimi nuk ka më objekt), me evidentimin e të cilave ankimi i palës ankuese “Marina Bay Saranda” SHPK nuk do të pranohej.

65. Lidhur me gabimin material, rezultojnë se është i vërtetë pretendimi i ngritur nga prokuroria mbi gabimin material në vendimin nr. 91, datë 24.02.2023, të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që konsiston tek faqja në të cilën është regjistruar prona mbi të cilën në regjistrin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, shënuar gabim numri i faqes 158, ndërkohë që faqja e saktë është 157. Konkretisht, pasuria e kërkuar për t’u vendosur masa e sekuestrimit është lehtësisht e evidentueshme në kërkesën e Prokurorisë së Posaçme drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë me të dhënat e tjera të evidentuara

nga aktet e administruara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, megjithatë vihet re kërkesën e prokurorisë, në përbërësin “faqe” ka një gabim material, gabim që është reflektuar edhe në vendimin e gjykatës në pikën 2 të dispozitivit, ndërsa përbërësit e tjerë të identifikimit të pronës janë të saktë. Për këtë konstatim Gjykata e Posaçme e Apelit i referohet certifikatës së pronësisë datë 26.1.2016, kartelës së pasurisë, por edhe të dhënave të tyre të pasqyruara në VKM nr. 514, datë 1.7.2020. Ndodhur në këto kushte rezulton lehtësisht e evidentueshme se jemi përpara një gabimi material, situatë për të cilën ligjvënësi ka lejuar mundësinë e ndreqjes edhe nga gjykata e apelit, në situatën kur është bërë ankim dhe ankimi pranohet, në bazë të nenit 114, të KPP. Në këto kushte, Gjykata e Posaçme e Apelit duhet të disponojë për ndreqjen e gabimit material në pikën 2 të dispozitivit të vendimit nr. 91, datë 24.2.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, përse i përket përbërësit “faqe të regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, të pasurisë mbi të cilën është caktuar masa e sekuestrimit, duke u lexuar nga “Faqe 158” në “faqe 157”,

66. Lidhur me themelin e çështjes në fokus të trajtimit të shkaqeve të ankimit Ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit, vlerëson se vendimi nr. 91, datë 24.02.2023, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është i drejtë dhe, si i tillë, duhet miratuar. Ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit konstaton se Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka arsyetuar në mënyrë të detajuar rreth kuptimit të sekuestrës preventive dhe kushteve ligjore për vendosjen e saj. Referuar parashikimit të paragrafit të parë të nenit 274 të KPP, kushtet e nevojshme ligjore për caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestrës preventive parandaluese janë: ekzistenca e indicjeve/të dhënave, pra, prania e (i) elementit të ashtuquajtur *fumus boni iuris* për kryerjen e një veprë penale apo të mundshme për t’u kryer në të ardhmen, si dhe (ii) prania e elementit të ashtuquajtur *periculum in mora*/rreziku i vonesës deri në kalimin e vendimit në gjë të gjykuar. Në lidhje me këtë kusht të fundit duhet verifikuar fakti rëndimit, apo zgjatjes së pasojës së veprës penale, apo lehtësimit të kryerjes së veprave të tjera penale, në raport me rrethanat dhe veçoritë e faktit konkret të dyshuar se është kryer apo do të kryhet, por dhe të sendit. Ndërsa përse i përket kushtit *fumus boni iuris*, pra, dyshim për kryerjen e një veprë penale, edhe pse pika 1 e nenit 274, të KPP nuk e përcakton shprehimisht, sekuestrimi parandalues bazohet në dyshimin, pra, të nënkuptuar nga vetë përmbajtja e nenit, se tashmë janë evidentuar të dhëna dëshmuuese apo elemente të aftë për të vërtetuar, konkretisht *fumus delicti* dhe, njëkohësisht, është e nevojshme prania e një sërë indicjeve që lidhin sendin apo pasurinë, me natyrën dhe llojin e veprës penale të dyshuar në raport edhe me faktet e parashtruara apo të grumbulluara mbi çështjen konkrete.

67. Avokati i palës ankuese (gjatë seancës gjyqësore në apel) u shpreh se nuk ka ende persona nën hetim në kuadër të këtij procedimi penal dhe se shoqëria ankuese, për të cilën parashtrroi se është vetëm qiramarrëse, nuk është nën hetim nga Prokuroria e Posaçme. Gjykata e Posaçme e Apelit arsyeton se masa e sekuestrës preventive nuk ka si kusht të saj faktin që më herët në kuadër të procedimit penal të ketë persona që të kenë marrë statusin e “personit nën hetim”, si dhe nuk ka si kusht të saj që subjekti i prekur, pra, mbajtës i një interesi konkret dhe aktual (trajtuar më lart në vendim) mbi pasurinë që vendoset masa e sekuestrës preventive të ketë në momentin e vendosjes së masës së sekuestrës, apo dhe më vonë statusin e personit në hetim. Ky kolegji arsyeton se, nuk paraqet asnjë rëndësi dhe, për pasojë, nuk përbën pengesë për vendosjen e sekuestrës preventive, fakti që kur personi që i atribuohet vepra penale nuk ka marrë statusin e të hetuarit, pasi teorikisht masa e sekuestrës preventive mbi pasurinë në zbatim të nenit 274, pika 1 të KPP, mund të vendoset edhe në situatat kur personi që i atribuohet një vepër penale mund të mos njihet fare. Me këtë arsyetim, rrethana e pretenduar nga avokati i palës ankuese mbi mungesën e personave që të kenë statusin e të hetuarit deri në këtë fazë të hetimit paraprak, nuk ka asnjë efekt mbi

vendimmarrjen e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë/gjyqtarit të hetimit që ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, duke caktuar masën e sekuestros preventive, si mase sigurimi pasuror, masë e cila, ndryshe nga ajo personale, nuk lidhet me personin, por me pasurinë.

68. Përsa i përket shkakut të ankimit mbi mungesën e arsytimit të vendimit të ankimuar, Gjykata e Posaçme e Apelit vlerëson se në vendimmarrjen e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë (gjyqtari i shqyrtimit të kërkesave në fazën e hetimit paraprak) janë arsyetuar ato rrethana të domosdoshme në funksion të caktimit të masës së sekuestros preventive. Më konkretisht, pasi ka pasyruar rrethanat e fakteve, ku përfshihen edhe arsyetime mbi shkeljet ligjore nga zyrtaret e lartë të Forcave të Armatosura dhe zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, të njëjta me ato të pretenduar edhe Prokuroria e Posaçme, gjykata ka konkluduar mbi faktin se në kuadër të procedimit penal në fjalë të regjistruar nga Prokuroria e Posaçme, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se janë konsumuar elementi i veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, e parashikuar neni 248 i Kodit Penal.

69. Gjykata e Posaçme e Apelit, duke marrë në konsideratë kushtet për caktimin e masës së sekuestros preventive, por dhe shkakun e ankimit se këto kushte mungojnë në rastin konkret, ndalet fillimisht në ekzistencën e kushtit *fumus boni iuris* për kryerjen e një vepre penale, edhe pse pika 1 e nenit 274, të KPP nuk e përcakton shprehimisht, por shprehet mbi lidhjen që duhet të ekzistojë midis sendit dhe veprës penale. Arsyetohet në vijim se pse në rastin konkret ka dyshim/*fumus delicti* për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim detyrë”, vepër kjo e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

70. Gjykata e Shkallës së Parë i është referuar parashikimit të nenit 248 të KP, “Shpërdorimi i detyrës”, duke konkluduar në dyshimin për kryerjen e kësaj vepre penale, vepër penale për të cilën dhe është kryer regjistrimi i procedimit penal dhe është arsyetuar dhe në kërkesën për caktimin e masës së sekuestros preventive është arsyetuar, pikërisht, dyshimi mbi përfshirjen e funksionarëve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura. Referuar përmbajtjes së nenit 248 të KP, interpretimit logjik të tij dhe gramatikor, në analizë të elementëve të sjelljes (anës objektive): “Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin”, përfshihen rastet kur: (1) veprimi i paligjshëm konsiston në shpërdorimin e pozitës zyrtare, duke kryer veprime apo mbajtur qëndrim mosveprues në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rastin kur (2) nuk përmbushen detyrat zyrtare. Për sa i përket elementëve të anës subjektive, kjo vepër penale kryhet me veprime dhe mosveprime me dashje, nga ana e personave që ushtrojnë funksione publike, veprimet dhe mosveprimet e të cilëve, duhet parë në harmoni me ligjin specifik mbi të cilin ata funksionojnë. Në këtë rast, dashja e subjektit përfshin dijeninë se po kryhen me dashje veprime në kundërshtim me ligjin, ose nuk po e kryen detyrën e tij, si dhe vetëdijen se këto i bën që të përfitojë nga pikëpamja materiale ose jomateriale, për vete apo për persona të tjerë, apo të sjellë dëm të interesit të shtetit apo shtetasve.

71. Edhe ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit konstaton në rastin konkret ekzistencën e elementeve të përshtatshme/dyshimin për të mbështetur konfigurimin e kësaj figure vepre penale, në frymën e parashikimit të nenit 274, pika 1 të KPP, që sendi mbi të cilën vendoset masa e sekuestros preventive lidhet me veprën penale. Gjithashtu, ky kolegji, sikurse do të analizohet edhe në vijim, vlerëson pathemelësinë e shkaqeve të ankimit të fokusuara mbi mungesën e kushteve për caktimin e sekuestros preventive, sipas nenit 274 të KPP.

72. Nga rrethanat e fakteve të përshkruara më lart rezulton se, falë procedurave së sipër përshkruara, është lidhur me date 16.7.2020 kontrata e qirasë për dhënien me qira edhe të pronës nr. 696 “Baza ndihmuese Limion, Sarandë, prej 39.446 m². Kjo e fundit rezulton të jetë e përfshire në planin e vendosjes dhe përhapjes, sipas Dekretit nr. 8539, datë 17.06.2014

8 Presidentit të Republikës së Shqipërisë. VKM nr. 514, e vitit 2020, “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 Euro/Kontrata ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës dhe Bashkimit të Shoqërive “Concord Investment” SHPK dhe “Kastrati Group” SHA si qiramarrës, për Pasurinë Shtetërore, Gjiri i Limionit, Sarandë, me sipërfaqe të përgjithshme 265 299,5 m², në Përgjegjësi Administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, është e bazuar vetëm në parashikimet e VKM nr. 54, të vitit 2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. Sipas pikës 5.3 të këtij VKM, “Ministria përgjegjëse për ekonominë propozon dhënien me qira të pasurisë shtetërore pa konkurrim dhe me çmimin simbolik 1 (një) euro/kontrata, kur me ofertë të pakërkuar, ka një propozim për zhvillimin e zonave të veçanta, duke investuar vlera mbi 100 000 000 (njëqind milionë lekë), me qëllim ngritjen e qendrave të organizuara sociale që ndikojnë për zgjidhjen e problemeve sociale ose për ushtrim të veprimtarive në fushën e sportit a të kulturës apo në fushën e turizmit ose të trashëgimisë kulturore.”.

73. Pra, prona nr. 696 “Baza ndihmuese” Limion, Sarandë, është trajtuar si një pasuri e zakonshme shtetërore, pa ndonjë status specifik, e cila mund të jepej me qira, duke u lidhur përfundimisht më datë 16.7.2020, kontrata e qirasë.

74. Gjykata e Posaçme e Apelit arsyeton, në vijim, rreth dy momenteve që paraqesin rëndësi, si në kuadër të trajtimit të kushtit mbi ekzistencën e dyshimit për veprën penale “Shpërdorim detyre”, gjithnjë brenda caqeve të nevojshme në fokus të kërkimit për marrjen e masës së sekuestros preventive, pra, të parashikimit të pikës 1 të nenit 274, pra për të mundësuar lidhjen e sendit të sekuestruar me veprën penale, por edhe në kuadër të shkaqeve të ankimit të ngritur. Konkretisht, *së pari*, nëse pronat e përfshira në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes mund të disponohen lirisht si pronat e tjera shtetërore, apo kanë një status më të veçantë dhe, *së dyti*, si përcaktohet operacionaliteti i pronave të përfshira në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes, në kushtet kur diskutohet dhënia me qira e pronave shtetërore të përfshira në këtë plan, në rrethanën kur shkak i arsyetuar për caktimin e masës së sekuestros preventive, por dhe në kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, është rreziku i cenimit të gatishmërisë dhe operacionaliteti i Komandës së Forcës Detare, rreziku i sigurisë kombëtare, ardhur si pasojë e dhënies me qira të pronës nr. 696, pronë e gjendur në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes.

75. Në vlerësim edhe të Gjykatës së Posaçme të Apelit, pronat e përfshira në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes nuk mund të jenë objekt material i kontratave të qirasë së pasurisë shtetërore, për sa kohë ato janë pjesë e këtij Plani. Për këtë kjo gjykatë i referohet ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe Autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Një ndër kompetencat e Presidentit të Republikës të përcaktuara në nenin 9, “Kompetencat e Presidentit të Republikës”, pika 1, shkronja “f”, e këtij ligji, është miratimi, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, i Planit të Vendosjes dhe Përhapjes së Forcave të Armatosura në kohë paqeje. Rëndësia e Planit të Vendosjes dhe Përhapjes ka gjetur trajtim edhe në vendimin nr. 10, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Objekt i shqyrtimit nga ana e kësaj gjykate ka qenë ligji nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe Autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Presidenti i Republikës i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar se ligji ka cenuar parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, pasi ka shkelur dispozitat kushtetuese që përcaktojnë funksionet dhe kompetencat e Presidentit të Republikës (Presidenti) si Komandant i Përgjithshëm të Forcave të Armatosura (FA); ligji nr. 64/2014 i heq Presidentit kompetenca që ai i gëzon si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, të cilat burojnë nga Kushtetuta (nenet 86, 168/2 dhe 169) dhe janë në përputhje me rolin e tij

asnjanës dhe standardet e përcaktuara për vendet anëtare të NATO-s (paragrafi 2 i vendimit të Gjykatës Kushtetuese). Në arsyetimin e saj kjo Gjykatë është shprehur edhe lidhur me vlerën e Planit të Veprimit dhe Përhapjes, qëndrim i cili citohet: “Për pretendimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 12/d të ligjit nr. 64/2014 24 Neni 12/d i ligjit nr.64/2014 parashikon se Kryeministri miraton, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, planin e vendosjes dhe të përhapjes së Forcave të Armatosura në kohë paqeje. Kërkuesi ka pretenduar se kjo dispozitë kufizon funksionin e tij, si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, tejkalon Kushtetutën, për sa i takon funksionimit dhe drejtimit të FA-ve, si dhe cenon parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve. 25. “Sipas nenit 169/1 të Kushtetutës, Presidenti në kohë paqeje ushtron drejtimin e FA-ve nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes. Në mënyrë të qartë Kushtetuta ka përcaktuar se është kërkuesi, si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, ai që ushtron drejtimin e FA-ve, në përputhje me pushtetin që vetë Kushtetuta i ka dhënë. Drejtimi i FA-ve ndërthur shume aspekte që mund të jenë të natyrës politike, strategjike, ushtarake, operative, teknike ose thjesht administrative. Për këto arsye dhe nisur nga karakteristikat e veçanta që mbart pozicioni i Presidentit, si Komandant i Përgjithshëm i FA, kushtetutbërësi ka përfshirë edhe ekzekutivin në procesin e drejtimit të FA-ve. Kjo i shërben koordinimit dhe konsultimit që Presidenti duhet të zhvillojë me ekzekutivin, si hallke e domosdoshme për ushtrimin e kompetencës drejtuese të FA-ve. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, kërkuesi drejton FA-të, duke respektuar hierarkinë e autoriteteve të drejtimit e të komandimit të FA-ve, sipas kuadrit kushtetues. Autoriteti i tij drejtues shtrihet në disa plane, si: planifikimi strategjik, në funksion të zhvillimit të planeve ushtarake strategjike dhe planeve të veprimit, çështjet dhe objektivat e sigurisë kombëtare, programet dhe nevojat ushtarake të FA-ve, buxheti që i takon FA, vendosja e shkalleve të ndryshme të gatishmërisë ushtarake, vendosja për mobilizimin dhe për provat e gatishmërisë luftarake të njësive rezerve, regjimi dhe rregullat e gatishmërisë luftarake, si dhe rekomandimi i masave që duhet të marrë ekzekutivi në varësi të nevojave që kanë FA (shih për më tepër nenin 9 të ligjit nr. 64/2014). 26. Plani i vendosjes dhe përhapjes së FA-ve, që u referohet dispozita ligjore konkrete, është aspekt organizativ i drejtimit të FA-ve me karakter strategjik. Gjykata vlerëson se Kushtetuta në nenin 169/1 është e qartë në rolin drejtues që i ka caktuar Presidentit, rol nga i cili ai nuk mund të përjashtohet, sidomos kur bëhet fjalë për aspekte të rëndësishme të drejtimit strategjik. Neni 12/d i ligjit nr. 64/2014 ia ka atribuuar Kryeministrit kompetencën për të miratuar, në bazë të propozimit të Ministrit të Mbrojtjes, planin e vendosjes dhe të përhapjes së FA në kohë paqeje, duke mos e përfshirë Presidentin në këtë aspekt. Në vlerësimin e Gjykatës, ky përjashtim tejkalon Kushtetutën, e cila shprehimisht ka përcaktuar se autoriteti drejtues i FA i takon Presidentit, i cili në kohë paqeje e ushtron nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes...” (citim).

76. Duke iu referuar këtij vendimit të Gjykatës Kushtetuese, plani i vendosjes dhe përhapjes së Forcave të Armatosura, që u referohet dispozita ligjore konkrete e analizuar nga Gjykata Kushtetuese, nenit 12/d i ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe Autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar nga kjo gjykate, është aspekt organizativ i drejtimit të Forcave të Armatosura me karakter strategjik. Parë në këtë këndvështrim, prona të përfshira në planin e vendosjes dhe përhapjes nuk janë pasuri që mund të trajtohen lirisht si pronat e tjera shtetërore për t’u dhënë me qira sipas VKM nr. 54/2014. por kanë një status të veçantë, pasi i shërbejnë sigurisë kombëtare të një vendi, ruajtjes së gatishmërisë dhe operacionalitetit të njësive apo reparteve të dislokuara në këto prona.

77. Në ndryshim nga çfarë pretendon mbrojtësi i palës ankuese ndër shkaqet e ankimit se operacionaliteti i bazës është përcaktuar dhe vijon të përcaktohet edhe tani nga Forca Detare, e cila ka dhënë aprovimin për dhënien me qira dhe se vlerësimi i operacionalitetit nuk

i përket Prokurorisë, por strukturave përkatëse ushtarake, kjo gjykatë arsyeton se, duke qenë që plani i vendosjes dhe përhapjes është aspekt organizativ i drejtimit të Forcave të Armatosura me karakter strategjik, operacionaliteti i pronave të vendosura në këtë plan kushtëzohet, pike se pari nga fakti i përfshirjes së pronës në këtë plan. Kjo, pasi drejtimi i Forcave të Armatosura nga Presidenti i Republikës, i cili miraton edhe planin e vendosjes dhe përhapjes, si aspekt organizativ i drejtimit me karakter strategjik, ndërthur shumë aspekte dhe ndër to edhe ato të natyrës operative, teknike ose thjesht administrative (paragrafi 25 i sipërcituar i vendimit të Gjykatës Kushtetuese). Për pasojë, çdo veprim për dhënien me qira të pasurive të përfshira në planin e vendosjes dhe përhapjes, një ndër to edhe pasuria nr. 696, duhet të paraprihet pikë së pari nga nxjerrja e pronës nga ky plan në përputhje me ligjin. Në këtë këndvështrim, gjendet i drejtë konkluzioni i arritur edhe nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë që vendosjen e sekuestros preventive, pikërisht, mbi pronën e përfshirë në planin e vendosjes dhe përhapjes, e konsideron të lidhur me rrezikun e cenimit të gatishmërisë dhe operacionalitetit të Komandës së Forcës Detare dhe të sigurisë kombëtare. Duke qenë kështu të hetuarit e funksionarëve shtetërorë mbi procedurën e dhënies me qira të pronës nr. 696 e quajtur “Baza Ndihmëse Limion Sarandë”, apo me hallkat e tjera të procedurës të analizuar edhe në kërkesën e Prokurorisë, parashtruar po kështu edhe nga gjykata e shkallës së parë, për veprime a mosveprime të funksionarëve shtetërorë që konsiderohen deri më tani, pra, në këtë fazë të hetimit paraprak, si “Shpërdorim detyrë”, vlerësohet edhe nga kjo gjykatë në nivelin e dyshimit të bazuar në prova për ekzistencën e kësaj vepre penale, por gjithnjë në nivelin e arsytimit të kërkuar si kusht për vendosjen e sekuestros preventive mbi një send, i kërkuar nga neni 274, pika 1 të KPP, si një send që lidhet me një vepër penale.

78. Shkaqet e ankimit: *“Forca Detare zotëron dhe zbaton planet operationale dhe çdo proces të realizuar nën pronën në administrim të saj: ndërtimi i infrastrukturës është në funksion të krijimit të këtij operacionaliteti që është thuajse inekzistent”*, gjenden nga ky kolegji të pabazuara. Në thelb këto pretendime lidhen me situatën në terren të Bazës Ndihmëse “Baza Ndihmëse Limion Sarandë” dhe kanë në fokusuar të dhënat teknike të objekteve të vendosura në këtë pronë, pa u parë aspak faktet në këndvështrimin e faktit se prona nr. 696 e quajtur “Baza Ndihmëse Limion Sarandë” gjendet në planin e vendosjes dhe përhapjes. Për sa kohë vijon të jetë në këtë plan, që përbën aspekt organizativ të drejtimit të Forcave të Armatosura me karakter strategjik, kjo përbën pengesë për t’u trajtuar si një pronë e zakonshme shtetërore. Prona të tilla më herët, nëpërmjet një Dekreti të Presidentit të Republikës, janë vlerësuar të lidhura me aspektin organizativ të drejtimit të FA, me karakter strategjik, për t’i shërbyer ruajtjes së gatishmërisë dhe operacionalitetit të forcës së dislokuara në të dhe, për këtë shkak, kanë dhe statusin e ndryshëm nga pronat shtetërore të zakonshme në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes. Të vlerësuarit e strukturave të ndryshme si Komanda e Forcës Detare, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe Ministria e Mbrojtjes (siç pretendohet në ankim), duke e zbritur në nivel teknik diskutimin mbi mundësinë dhe detyrimin e ruajtjes së operacionalitetit të Forcës Detare nga pala investitore dhe qiramarrëse, shoqëria “Marina Bay Saranda” SHPK, vlerësimet këto të këtyre strukturave që kanë shërbyer edhe mbështetje për procedurat e konkretizuara në mënyrë fundore me dhënien e pronës me qira në zbatim të VKM nr. 54, të vitit 2014, nuk paraqesin asnjë vlerë juridike, për sa kohë prona nr. 696 vijon të jetë në planin e vendosjes dhe përhapjes. Ky plan ka një procedurë të posaçme të miratimit të rregulluar me ligjin nr. 64/2014, ligj i dalë në mbështetje edhe të nenit 169, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që parashikon se: *“Kompetencat e Presidentit të Republikës si Komandanti Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe ato të Komandantit të Forcave të Armatosura dhe varësia e tyre nga organet kushtetuese, caktohen me ligj”*.

79. Ky Kolegj i Gjykatës së Posaçme të Apelit vlerëson se, megjithëse disa nga personat që tregojnë rrethana të hetimit janë shprehur se prona nr. 696 e vendosur në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes, nuk mund të jepej e gjithë me qira, por vetëm pjesërisht dhe pasi të nxirrej nga plani i vendosjes dhe përhapjes, duke përbërë ky moment një aspekt ligjor, vlera e deklarimeve të personave që tregojnë rrethana të hetimit, nuk paraqet rëndësi thelbësore për të evidentuar faktin nëse pronat e planit të vendosjes dhe përhapjes mund ose jo të jepen me qira. Është kjo gjykatë ajo që vlerëson, sikurse ka bërë më lart, aspektet që lidhen me mundësinë e shkeljes së dispozitave ligjore konkrete në kuadër të procedurave të ndjekura dhe që kanë në fundore të tyre lidhjen e kontratës së qirasë me palën ankuese edhe për një pronë pjesë e planit të vendosjes dhe përhapjes. Këtë qëndrim e parashtroi dhe mbrojtësi i palës ankuese gjatë gjykimit në apel, përmendur edhe ndër shkaqet e ankimit, duke u shprehur se deklaratimet e personave, megjithëse nuk përmenden në vendimin e shkallës së parë, nuk paraqesin ndonjë rëndësi në këtë aspekt.

80. Kushti tjetër për vendosjen e masës së sekuestros preventive, në kuptim të nenit 274, pika 1 të KPP, ka të bëjë me elementin e ashtuquajtur *periculum in mora*/rreziku i vonesës. Duket që Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë e ka arsyetuar vendimin duke e parë rrezikun e disponimit të lirë të pasurisë mbi të cilën ka vendosur sekuestros preventive në dy këndvështrime: “mund të lehtësojë apo të zgjasë pasojat e veprës penale apo të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale” dhe “vendosja e masës së sekuestrimit parandalon rrezikun e shitjes, së tjetërsimit apo humbjes së pasurisë që mund të konfiskohet”. Ky kolegj vlerëson se, rrethana që shërben në këtë situatë faktesh për vendosjen e masës së sekuestros preventive është mundësia që përdorimi apo aksesimi i pronës nga pala ankuese mund të lehtësojë apo të zgjasë pasojat e veprës penale, por nuk përjashtohet as mundësia që të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale. Theksohet se Prokuroria e Posaçme ka arsyetuar “që pjesa e bazës ushtarake do të kthehet në një kantier ndërtimi derisa të bëhet fshati turistik dhe në parashitjesën e dhënë gjatë gjykimit në apel u shpreh: “punimet për investim në fushën e turizmit dhe ndërtimi i Portit Turistik janë në fillim e sipër”. Këtë linjë e ka pranuar me të drejtë edhe Gjykata e Shkallës së Parë, kur është shprehur se duhet vendosur sekuestro preventive për të mundësuar ndërprerjen dhe kryerjen e veprimeve të investimit në fushën e turizmit apo edhe ndërtime të tjera nga investitori në këtë pronë, pasi cenohet gatishmëria dhe operacionaliteti i Komandës së Forcës Detare, pikërisht mbi pronën nr. 696, pronë e vendosur në plan vendosje dhe përhapje, duke vënë në rrezik sigurinë kombëtare.

81. Te pretenduarit ndër shkaqet e ankimit të faktit se prona është në disponim dhe administrim të Forcës Detare, bie ndesh me provat, pasi në këtë rast është e qartë se mbi pronën në fjalë janë ndërmarrë veprime konkrete, të cilat në vetvete, megjithëse duken të harmonizuara me procesverbale të mbajtur edhe me përfaqësues të Forcave të Armatosura, i lejojnë kompanisë ankuese qiramarrëse të kryejë veprime dhe të ketë akses në përmbushje të planit të investimit mbi këtë pronë. Është fakt që, nëpërmjet dhënies me qira sipas kontratës së lidhur midis palëve me datë 16.7.2020, parashikohet se subjekti privat, pra, pala ankuese, do të pajiset me leje ndërtimi dhe shfrytëzimi të objekteve turistike, që parashikohet të ndërtohen brenda territorit të bazës detare, veprime këto që cenojnë sigurinë kombëtare, duke qenë se kjo pronë (prona nr. 696) me Dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë është brenda planit të vendosjes dhe përhapjes së forcave të armatosura dhe funksioni i saj specifik është për mbrojtjen kombëtare, e përcaktuar si e tillë nëpërmjet një procedure të posaçme sipas ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe Autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

82. Linja e arsyetimit të përdorur nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë mbi mundësinë apo rrezikun e shitjes, tjetërsimit apo humbjes së pronës, nuk mbështetet nga ky kolegj, duke marrë në konsideratë rrethanat e faktit të rezultuara, pretenduar edhe nga pala

ankuese. Kemi të bëjmë me një truall shtetëror të përfshirë në planin e vendosjes dhe përhapjes dhe se shoqëria vetëm e ka marrë me qira me afat 20 vjet, rrethanë kjo tregon se prona nuk mund të transferohet juridikisht tek të tretët.

83. Pavarësisht faktit se prona mbi të cilën është vendosur sekuestro preventive është pronë shtetërore, duke qenë ndër shkaqet e ankimit edhe fakti se është vendosur sekuestro mbi një pronë shtetërore, Gjykata e Posaçme e Apelit vlerëson se, sikurse rezultojnë rrethanat e faktit, të qenurit pronë shtetërore, nuk e përjashton atë apriori nga objektet mbi të cilat mund të vendoset sekuestro preventive. Përkatësia e pronësisë së sendit nuk paraqet relevancë në rastin e vendosjes së një mase sekuestro preventive, në kuptim të nenit 274, pika 1 të KPP. Kjo, në kushtet kur kontrata e qirasë, e shtrirë edhe mbi pronën e përfshirë në planin e vendosjes dhe përhapjes, i ka kaluar qiradhënësit tagra të lidhura me të drejtën e kryerjes së veprimeve të investimit në fushën e turizmit apo edhe ndërtime të tjera edhe në këtë pronë. Pra, për palën ankuese, falë procedurave të përshkruara gjerësisht më lart, vijnë procedurat për dhënien e aksesit dhe përdorimit të pronës në fjalë (megjithëse “dorëzimi përfundimtar”, analizuar edhe në vijim, nuk është bërë). Janë, pikërisht, këto të drejta përdorimi apo aksesit të palës ankuese që janë konkretizuar edhe në procesverbalin datë 29.03.2022 për marrjen në dorëzim të pronave, ku përfshihet edhe marrja në dorëzim e objekteve të pronës nr. 696. Ky procesverbal i hap rrugë vijimit të procedurave për realizimin e qëllimit të përdorimit edhe së pronës së përfshirë në planin e vendosjes dhe përhapjes, sipas procedurave të pasqyruara hollësisht më lart.

84. Në këtë aspekt, në ndryshim nga çfarë pretendon ndër shkaqet e ankimit pala ankuese, prona nr. 696 në pronësi të shtetit vendoset nën sekuestron preventive, në kushtet kur vlerësohet se të ushtruarit e tagrave të buruara nga kontrata e qirasë nga kjo palë mbi këtë pronë të përfshirë në planin e vendosjes dhe përhapjes, do të rëndonte pasojat e veprës penale dhe do të shtonte rrezikun mbi gatishmërinë dhe operacionalitetin e Komandës së Forcës Detare, duke vënë në rrezik vazhdues interesat kombëtare të Sigurisë së Republikës së Shqipërisë, në vështrim 18 Kreut III, të VKM nr. 628, datë 25.9.2019, “Për miratimin e dokumentit të rishikimit të strategjisë të mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë”, përsa kohë pala qiramarrëse/investitore ka akses në përdorimin e pronës në fjalë.

85. Në linjën e mësipërme të arsyetimit, është e qartë se, përsa i përket sekuestrimit parandalues, jemi në kushtet e ekzistencës së përshtatshmërisë së pasurisë së sekuestruar, në kuptimin që pasuria që i nënshtrohet sekuestrimit parandalues karakterizohet nga një instrument i brendshëm, specifik, strukturor në lidhje me krimin e kryer sikurse kërkohet në nenin 274, pika 1 të KPP: “Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj”. Është e qartë se në situatën e fakteve të rezultuara nuk paraqitet një marrëdhënie thjesht e rastësishme midis kësaj pasurie dhe krimit të “Shpërdorimit të detyrës” të dyshuar si të kryer, por kemi të bëjmë me një raport apo marrëdhënie konkrete, të konceptueshme midis sendit dhe veprës penale.

86. Elementi “*periculum in mora*”/rreziku i vonës, duhet që të paraqitet aktual, për t’u vlerësuar duke iu referuar situatës ekzistuese, jo vetëm në momentin e marrjes së masës reale të sigurimit, por edhe gjatë vlefshmërisë së masës së sekuestros preventive. Pra, është e rëndësishme që të mund të konsiderohet të paktën e mundshme që pasuria të paraqesë një natyrë instrumentale në lidhje me rëndimin ose zgjatjen e pasojave të krimit të dyshuar ose lehtësimin e kryerjes së krimeve të tjera”. Në të njëjtën linjë arsyetimi ka ecur praktika e Gjykatës së Lartë, p.sh në vendimin nr.201, datë 09.12.2015 ku është arsyetuar se: “... Në këtë mënyrë, elementi i *periculum in mora*, nuk duhet të konsiderohet si një eventualitet i përgjithshëm e abstrakt, por si një probabilitet realist, që sendi objekt i mundshëm sekuestrimi preventiv, të bëhet shkak rëndues, zgjatës, për veprën penale të supozuar, apo shkak lehtësues për vepra të tjera të supozuara se mund të ndodhin efektivisht. Kjo

mbështetur në llojin dhe natyrën e sendit dhe tërësinë e rrethanave konkrete dhe duke u bazuar në nevoja reale dhe jo gjasa thjesht teorike...

87. Në përfundim, Gjykata e Posaçme e Apelit vlerëson se shkaku i ankimit i lidhur me faktin se sekuestroja është vendosur mbi një pronë shtetërore, në situatën e fakteve të rezultuara, nuk paraqet relevancë dhe prona mbi të cilën është vendosur sekuestroja preventive konsiderohet “e përshtatshme” në kuptim të nenit 274, pika 1 të KPP për t’u vendosur kjo mase parandaluese në funksion të shmangies së mundësisë së rëndimit ose zgjatjes së pasojave të veprës penale. Nga ana tjetër, nuk përjashtohet as mundësia që lënia e aksesit në përdorim palës ankuese/qiramarrëse mbi pronën në fjalë të të lehtësojë edhe kryerjen vepra të tjera penale. Kjo fundit edhe për shkak të cilësisë së veçantë të kësaj prone, cilësi që i buron nga qenia në planin e vendosjes dhe përhapjes, që përfaqëson aspekt organizativ të drejtimit të Forcave të Armatosura me karakter strategjik.

88. Gjithashtu, pretendimi se: *“duke u dhënë në ruajtje të një kompanie private është vënë në rrezik serioz potencial operacionaliteti, siguria kombëtare dhe interesi publik në përgjithësi”*, në vlerësim të këtij kolegji nuk lidhen me kushtet e kërkuara nga neni 274, pika 1 të KPP për vendosjen e një mase sekuestro preventive, por lidhen me administrimin e pronës mbi të cilën është vendosur një mase e tillë, i cili realizohet mbi zbatimin e një ligji tjetër, konkretisht të ligjit nr. 34, të vitit 2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara dhe akteve të dala në zbatim të tij.

89. Ndër shkaqet e ankimit nga pala ankuese ngrihet edhe fakti se nëpërmjet vendosjes së sekuestros preventive mbi këtë pronë, nuk është marrë në konsideratë proporcionaliteti, në kushtet kur, sipas palës ankuese, qëllimi i kontratës së qirasë dhe kushtet e saj, kanë të qartë elementin e interesit publik të investimeve, jo vetëm për sa i përket infrastrukturës së Bazës Ndihmuese, por edhe në tërësi investimit turistik në sipërfaqen tej asaj të administruar nga Komanda e Forcës Detare që do të mbetet në pronësi shtetërore. Gjykata e Posaçme e Apelit arsyeton se në këtë rast, për t’u vendosur sekuestro preventive mbi këtë pasuri merret në konsideratë mbrojtja e interesave kombëtare të Shtetit Shqiptar. Edhe në mundësinë me te vogël të rrezikimit për shkak të dhënies me qira të sipërfaqes së pronës nr. 696 në administrim të Forcës Detare, të ndodhur në planin e vendosjes dhe përhapjes që përfaqëson aspekt organizativ të drejtimit të Forcave të Armatosura me karakter strategjik (sipas terminologjisë së Gjykatës Kushtetuese në vendimin e analizuar më sipër), interesi kombëtar i Shtetit Shqiptar prevalon mbi interesat ekonomik të shoqërisë të lidhura me investimet që do të kryhen nga pala ankuese dhe për pasojë, nuk e gjen të bazuar shkaku i ankimit të përqendruar në mungesën e proporcionalitetit në marrjen e masës së sekuestros preventive. Shkak tjetër në ankimin e palës ankuese është pretendimi mbi mungesën e elementit të urgjencës në marrjen e masës së sekuestros preventive, pasi sipas palës ankuese, kallëzimi që ka sjellë regjistrimin e procedimit penal lidhur me këtë çështje është paraqitur dy vite para se të kërkohej nga Prokuroria dhe të caktohej nga Gjykata masa e sekuestros preventive. Gjykata e Posaçme e Apelit evidenton faktin se, aktualisht, paraqitet evident fakti që investimi mbi pronën e marrë me qira, pra, edhe mbi pronën nr. 696 të përfshirë në planin e vendosjes dhe përhapjes nuk është realizuar ashtu sikurse është marrë përsipër. Më datë 10.12.2021 është përpiluar dokumenti nr. 4389 prot., i titulluar “Akt-Marrëveshje me kompaninë “Marina Bay Saranda” për dhënien e aksesit për fillimin e punimeve për ndërtimin e objekteve në interes të komandës së Forcës detare dhe lejimin për kalimin e mjeteve dhe të personelit që do të punojnë për ndërtimin e dallgëthyesit në pronat në administrim të komandës së forcës detare, Gjiu i Limionit, Sarandë. Ndërsa sipas procesverbalin nr. 875/2 regj., datë 30.3.2022 dhe nr. 10 regj., datë 29.3.2022, Komisioni i ngritur me urdhër të Komandës së Forcës Detare nr. 90, datë 12.3.2022. “Për krijimin e komisionit për dorëzimin e pronës nr. 696 (Baza ndihmuese)....”, dorëzon pronat në

administrim, duke u marrë në dorëzim nga shoqëria një sërë objektesh të shtrira edhe në pronën nr. 696 dhe kjo në funksion të qëllimit të përdorimit të pronës sipas kontratës së qirasë (fq. 14 e këtij akti). Pra, pavarësisht përmbajtjes së Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes, sipas të cilit (pika 7), dorëzimi përfundimtar i pronës do të behet, vetëm pasi investitori të ketë ndërtuar bazën e re siç ka kërkuar Komanda e Forcave Detare, kjo gjykatë vlerëson se masa e sekuestros preventive mbi këtë pasuri është vendosur në një kohë që pritej të vijonin veprimet dhe investimet mbi këtë prone, duke qenë kështu ajo e aksesueshme edhe nga pala qiramarrëse/investitore. Për pasojë, edhe në këtë moment aktual do të vijonte të ishte prezent mundësia që përdorimi/aksesimi i pronës nga pala qiramarrëse të lehtësojë apo të zgjasë pasojat e veprës penale apo të lehtësojë edhe vepra të tjera penale të lidhura me pronën e sekuestruar.

90. Në lidhje me mungesën e urgjencës të ngritur si shkak ankimi nga shoqëria “Marina Bay Saranda” SHPK, ky kolegji merr në konsideratë, përveç sa më lart edhe dyshimin, mbi bazën e të dhënave të administruara deri në këtë fazë të hetimit, për ndryshim të projektit që ka shërbyer si bazë për daljen e VKM nr. 514/2020, si në sipërfaqe, ashtu dhe në vëllim të punimeve. Dhe kjo është mundësuar nëpërmjet aktivizimit të një grupi tjetër pune pranë Komandës së Forcës Detare, që ka marrë në shqyrtim projektin e propozuar nga investitori për të rishikuar projektin, ku disa prej anëtarëve rezultojnë të kenë qenë edhe në përbërje të grupit të punës të krijuar në funksion të përgjigjes së datës 18.6.2022 drejtuar Shefit të të Shtabit të Përgjithshëm, duke shfaqur mendimin e tyre në përbërje të këtij grupi të fundit mbi variantin më të mirë të ripozicionimit të bazës ndihmuese”, por në vijim kanë pranuar rishikimin e projektit të propozuar nga investitori. Pikërisht, dyshimi mbi ndryshimet në projektin që ka shërbyer si bazë për daljen e VKM nr. 514/2020, “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 Euro/Kontrata, është një element tjetër se pse nuk mund të shërbejë si argument i palës ankuese “Marina Bay Saranda” SHPK “mungesa e urgjencës”, në kuadër të kërimit të kësaj pale për heqjen e masës së sekuestros preventive, pra për shfuqizimin e vendimi të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë që ka vendosur masën e sekuestros preventive mbi pasurinë nr. 696. Nga ana tjetër, prania e elementit të ashtuquajtur *periculum in mora*/rreziku i vonesës, shtrihet deri në kalimin e vendimit në gjë të gjykuar. Pra, masat e sigurimit pasuror nuk përjashtohet mundësia të vendosen deri në momentin kur procedimi penal të ketë përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Për pasojës nuk ka sens të pretendohet se masa sigurimit pasuror në këtë fazë të hetimit duhet hequr për shkak të mungesës së urgjencës.

91. Nga ana tjetër, prania e elementit të ashtuquajtur *periculum in mora*/rreziku i vonesës, shtrihet deri në kalimin e vendimit në gjë të gjykuar. Pra, masat e sigurimit pasuror nuk përjashtohet mundësia të vendosen deri në momentin kur procedimi penal të ketë përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Për pasojës nuk ka sens të pretendohet se masa sigurimit pasuror në këtë fazë të hetimit duhet hequr për shkak të mungesës së urgjencës.

92. Ndër shkaqet e ankimit të shoqërisë “Marina Bay Saranda” SHPK është dhe pretendimi se prokuroria dhe, më tej, dhe gjykata e faktit kanë konfunduar kontratën koncesionare të portit turistik dhe shërbimeve “Marina Limon” të lidhur me shoqërinë koncensionare Bashkimi i Operatorëve “Kastrati Group” SHA dhe “EDIL AI-IT SHPK, e cila, sipas palës ankuese, nuk ka lidhje me kontratën e qirasë dhe me pronën e vendosur nën sekuestro. Kjo gjykatë konstaton se të dhënat e deritanishme të hetimit paraparak tregojnë se me me shkresën nr. 402/8 prot., datë 11.06.2020, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka ridërguar për mendim projektvendimin, “Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP për objektin “Dhënie me koncesion/PPP të portit turistik dhe shërbimeve “Marina Limon” dhe i kërkon mendim Ministrisë së Mbrojtjes mbi një projekt-vendim, duke i bashkangjitur

kërkesës edhe një hartë të detajuar të zonës ku do të shtrihet koncesioni (dokumentacioni teknik i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve “Kastrati Group” SHA dhe “EDIL AI-IT SHPK”), Procedura e parë e këtij lloji me të njëjtin ofertues i përket muajit janar po të vitit 2020 ku institucionet si, Komanda e Forcës Detare, Drejtori i Shtabit të Përgjithshëm, Ministri i Mbrojtjes nuk janë shprehur dakord për shkak edhe të faktit se projekti i paraqitur përfshinte edhe pronën nr. 696 të përfshirë në planin e vendosjes dhe përhapjes, duke u evidentuar në këtë komunikim shkresor fakti që prona në fjalë ka këtë status. Ka dyshime të bazuara se zona koncesionare përfshin edhe sipërfaqe/sipërfaqen e pronës nr. 696 “Baza Ndihmuese” Limion, Sarandë, pra sipërfaqja për të cilën dhe është vendosur masa e sekuestros dhe, për pasojë, nuk mund të thuhet se ka konfondim nga prokuroria apo nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ndërmjet kontratës së qirasë dhe kontratës koncesionare. Sikurse u pasqyruan më lart rrethanat e fakteve dhe veprimet hetimore, Prokuroria e Posaçme ka ngritur dyshime se zyrtarët e lartë të Forcave të Armatosura dhe zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, kanë kryer veprime në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore në praktikën e dhënies me qira dhe dhënies me koncesion të pronës nr. 696, të njohur si “Baza Ndihmuese Limion Sarandë.

93. Për pasojë Gjykata e Posaçme e Apelit nuk konstaton konfondim nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë lidhur dhe linjën e arsytimit që konsiston në mundësinë e investimit në fushën e turizmit apo edhe ndërtime të tjera, arsyetim ky në kuadër të lidhjes së kërkuar nga neni 274, pika 1 i KPP, lidhjes së sendit me veprën penale (me dyshimin për këtë të fundit). Pra, prona nr. 696 është e përfshirë në planin e vendosjes dhe përhapjes dhe masa e sekuestros preventive mbi këtë pronë, shmang aksesin dhe përdorimin e saj nga subjekte private, sikurse është dhe pala ankuese “Marina Bay Saranda” SHPK, pra shmang mundësinë e rëndimit ose zgjatjes së pasojave të veprës penale, apo lehtësimit të kryerjes së veprave të tjera penale, nën dritën e arsytimit të mësipërm.

94. Si konkluzion, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vlerëson se shkaqet e ankimit të palës ankuese “Marina Bay Saranda” SHPK janë të pabazuara dhe vendimi nr. 91, datë 24.2.2023, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duhet miratuar.

95. **Kundër vendimit** nr. 9, datë 3.4.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, **ka paraqitur rekurs pala e interesuar Marina Bay Saranda SHPK**, me anën e të cilit kërkon që: *“në bazë të shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 441 të Kodit të Procedurës Penale të ndryshojë vendimet e gjykatave të faktit dhe të disponojë për heqjen e masës së sekuestros preventive për pasurinë nr. 696, me sipërfaqe 39446 (tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e dyzet e gjashtë) m², me emërtimin “Baza Ndihmuese”, Limion, Sarandë, regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, me nr. 1/416, Zona Kadastrale 8642, Volumi 30, Faqe 157, ose në alternativë, në bazë të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 441, të prishë vendimin nr. 9, datë 3.4.2023, të Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe të kthejë çështjen për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues.”*. Në rekurs janë parashtruar këto shkaqe:

- 1. Mosrespektimi dhe zbatimi i gabuar i ligjit material dhe procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore

- Shkaqet procedurale

- Në ankimin tonë të paraqitur ne Gjykatën e Apelit, kemi parashtruar si shkak ankimi faktin që: *“Në vendimin nr. 91, datë 24.2.2023, Gjykata e Shkallës së Parë konkludon se krijon bindjen e saj për domosdoshmërinë e marrjes së masës së sekuestros preventive, pasi vlerëson se plotësohen kushtet e parashikuara nga pika 1, e nenit 274, të Kodit të Procedurës Penale, por ky konkluzion i Gjykatës është paarsyetuar në drejtim të rrethanave konkrete që krijojnë bindjen e saj për plotësimin e kriterëve në fjale, duke cenuar rëndë garancitë*

procedurale të lidhura me arsyetimin dhe standardin e arsyetimit të Vendimit Gjyqësor, e për pasojë cenon te drejtën për akses në Gjykatë dhe procesin e rregullt ligjor, që në kuptim të praktikës së konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese sjellin për pasoje pavlefshmërinë e Vendimit “Pra, në bazë të Jurisprudencës së Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, kemi kërkuar nga Gjykata e Apelit që ta konstatonte mungesën e arsyetimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, për shkak të pasojës së rëndë të shkeljes së garancive procedurale.

- I vetmi arsyetim që bën Gjykata e Shkallës së Parë në vendimin objekt ankimi është pjesa abstrakte që i referohet jurisprudencës dhe praktikës së Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në terma të përgjithshëm mbi analizën e elementëve që duhet të përmbushen për të sjellë domosdoshmërinë e marrjes së masës së sekuestros preventive, por në fakt bën të kundërtën e jurisprudencës dhe praktikës së cituar prej saj dhe nuk arsyeton në asnjë moment në terma konkretë mbi rrethanat, provat që ndikojnë në rastin konkret për të sjellë domosdoshmërinë e masës së sekuestros preventive.

- Gjithçka tjetër e shkruar në vendimin objekt ankimi janë thjesht dhe vetëm rrethana faktike siç janë parashtruar nga Prokuroria, pa bërë ndonjë analizë ligjore mbi ndonjë prej tyre në veçanti apo lidhjen e tyre me nevojat e marrjes së masës së sekuestros preventive, urgjencës në marrjen e masës, mënyrën se si ndikojnë në rëndimin e veprës penale të dyshuar apo qoftë edhe në mundësinë e ardhjes së veprave të tjera penale.

- Konkretisht, “arsyetimi konkret i Gjykatës së Shkallës së Parë përmbledhet në paragrafin 62 të Vendimit, që po e citojmë më poshtë meqenëse përbëhet nga dy fjali të vetme: “Së pari, gjykata çmon se në ngarkim të të dyshuarve të këtij procedimi penal ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se është konsumuar elementi i veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Së dyti, Gjykata çmon gjithashtu se ekziston rreziku se disponimi i lirë i pasurisë së sipërcituar mund të lehtësojë apo të zgjasë pasojat e veprës penale apo të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale. Vendosja e masës së sekuestrimit parandalon rrezikun e shitjes, se tjetërsimit apo humbjes së pasurisë që mund të konfiskohet. Ndaj duhet të ndërpritet kryerja e investimeve në fushën e turizmit apo edhe ndërtime të tjera nga investitori, pasi cenohet gatishmëria dhe operacionaliteti i KFD, pikërisht mbi pronën 696, e vendosur në Plan Vendosi dhe përhapje, duke vënë në rrezik sigurinë kombëtare”.

- Në këto dy fjali që përmbledhet i gjithë vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, nuk ka asnjë arsyetim dhe as që përmendet ndonjë rrethanë faktike/prove/indicje dhe/ose mënyra se si ato do të ndikojnë në drejtim të parandalimit të pasojave të veprës së dyshuar apo veprimeve të tjera kriminale, duke e bërë këtë vendimmarrje të saj të pavlefshme, pasi cenon procesin e rregullt ligjor, si një garanci procedurale penale dhe njëkohësisht e drejtë themelore Kushtetuese, parashikuar nga nenet 42 dhe 142 të Kushtetutës. Në këtë kundër, praktika e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese, ku për ilustrim përmendim vendimin nr. 20, datë 22.9.2022, në të cilin Gjykata është shprehur se: “Në jurisprudenten e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejte. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (shih vendimin nr. 10, datë 4.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese). Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese). Në aspektin e kontrollit kushtetues Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara me sipër, të

cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (shih vendimet nr. 63, datë 23.9.2015; nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese).”.

- Çuditërisht, Gjykata e Apelit, edhe pse shprehet se e rrëzon këtë pretendim të Ankimit, pasi Gjykata e Shkallës së Parë ka argumentuar rrethanat konkrete dhe jo vetëm ato abstrakte, nuk tregoi në vendimin e saj ndonjë fjali më shumë se ato të cituara nga ana jonë të paragrafit 62 të Vendimit të Shkallës së Parë dhe në të gjitha rastet që apeli shprehet se është dakord me vlerësimin/arsyetimin/qëndrimin e Shkallës së Parë, në fakt janë vlerësim/arsyetim/qëndrim që shfaqen rishtazi në vendimin objekt rekursi dhe jo në vendimin e Shkallës së Parë. Përsa kohë që Gjykata e Apelit miraton vendimin e vendosjes së sekuestros preventive të vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë, kjo do të thotë që nga ana e saj është miratuar një vendim i paarsyetuar, në shkelje të garancive procedurale penale e kushtetuese të palës së interesuar.

- Sjellim në vëmendje të Gjykatës së Lartë se në rastin kur Gjykata e Apelit shqyrton ankimin ndaj një vendimi për marrje mase sekuestro preventive dhe vendos për miratimin e vendimit të ankimit (si në rastin konkret), nuk mundet që ta realizojë këtë miratim mbi një arsyetim të munguar në vendimin objekt ankimi dhe mbi një arsyetim vetëm të Gjykatës së Apelit që bëhet rishtazi dhe nuk gjendet në vendimin e Shkallës së Parë, pasi kjo vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 276 të Kodit të Procedurës Penale.

- 1.1.B Gjykata e Apelit, përsërit të njëjtin gabim procedural të Shkallës së Parë dhe konfondon Kontratën Koncesionare me Kontratën e Qirasë, duke u shprehur se krijohen dyshime të arsyeshme për disponimin në Kontratën Koncesionare të pronës objekt sekuestro. Gjykata e Apelit, mbi dyshime të paarsyeshme që nuk referohen në asnjë provë apo indicje konkrete, konkludon se Kontrata Koncesionare disponon mbi pronën objekt sekuestroje dhe në mënyrë të habitshme këtë konkluzion e arrin pa mendimin e ndonjë eksperti vlerësues, që të mund qoftë edhe të konstatonte një fakt të tillë në aktet shkresore,

- Në Ankimin tonë, e kishim parashtruar si pretendim dhe kemi sqaruar Gjykatën e Apelit se Kontrata Koncesionare (Kontrata e Koncesionit nr. 864 rep., e nr. 380 kol., datë 23.6.2020, e nënshkruar ndërmjet Autoritetit Kontraktor Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Shoqërisë Koncesionare Bashkimi i Operatorëve “Kastrati Group” SHA dhe Shoqëria “Edil Al-It” SHPK, në fakt nuk ka asnjë lidhje me pronën e vendosur nën sekuestro, por ka për objekt “Dhënie me Koncesion/Partneritet Publik Privat të Portit Turistik dhe të Shërbimeve “Marina Limion”. Është pikërisht ky dualitet në parashtrimet e Prokurorisë dhe vendimin e Shkallës së parë, pra herë duke përmendur procedura të para Kontratës së Koncesionit dhe herë duke përmendur procedura të Kontratës së Qirasë, që ka sjellë edhe konfondimin e Gjykatës deri në lajthim juridik në “arsyetimin” e saj për rrezik të shitjes apo tjetërsimit të pronës së sekuestruar apo ndalimit të veprimeve të investimit në fushën e turizmit, veprime këto që nuk janë fare të mundshme për t'u realizuar si ligjërisht ashtu edhe faktikisht.

- Lidhur me pronën e vendosur nën sekuestro nga Gjykata e Shkallës së Parë, Shoqëria “Marina Bay Saranda” SHPK ka funksion të kushtëzuar nga Kontrata e Qirasë dhe Akt Marrëveshjet e nënshkruara me Komandën e Forcës Detare, në bazë të të cilave ka si detyrim eksplicit ndërtimin si të bankinës që do të përdoret nga Forca Detare ashtu edhe të infrastrukturës mbështetëse dhe të gjitha këto specifikime janë të nënshkruara pikërisht nga vetë Komandanti i Forcës Detare pikërisht për shkak të kompetencës së vetme ekskluzive mbi administrimin e kësaj prone të bazuar mbi planet operationale të kësaj Force Detare.

- Çuditërisht, Gjykata e Apelit në vendimin objekt rekursi, edhe pse konstaton lajthimin juridik të Gjykatës së Shkallës së Parë mbi ndalimin e shitjes, tjetërsimit dhe investimeve turistike në pronën objekt sekuestro preventive, vazhdon t'i qëndrojë konkluzionit të Shkallës së Parë që kjo pronë disponohet në Kontratën Koncesionare. Pra, me këtë

logjikë prona është dhënë me koncesion dhe me qira njëkohësisht??? Gjykata e Apelit nuk kuptoi ose nuk dëshoi të kuptojë se përfshirja e Kontratës Koncesionare në këtë vendimmarrje sekuestrore preventive është bërë nga Kallëzuesi dhe vetë Prokuroria, për faktin e thjeshtë sepse nuk ka asnjë lloj shkelje ligjore në Kontratën e Qirasë lidhur me pronën objekt sekuestro, për të cilën edhe vetë Kallëzuesi ka dhënë miratim me shkrim.

- Konkluzioni i të dy Gjykatave, duke mos marrë mendimin teknik të një specialisti të fushës që do të jepte një përcaktim të qartë lidhur me disponimin e kësaj prone dhe me anë të cilit Akt është bërë ky disponim, është një shkelje e rëndë procedurale dhe vendos precedent të rrezikshëm gjyqësor. E themi këtë jo në kuptim të të provuarit në themel të dyshimeve, por marrja e një mendimi të një eksperti do të ishte përcaktues për vetë ngritjen e një dyshimi, pasi qartësisht Kontrata Koncesionare nuk ka asnjë lidhje me atë të qirasë, por përfshihet vetëm sepse komunikimet e paraqitura si provë të vitit 2020 (që flasin për mundësinë e dhënies së një koncesioni) të lidhura me komunikimet rreth lidhjes së Kontratës së Qirasë, krijojnë dukje të gabuar dhe dyshime të rreme mbi faktet penale të paraqitura.

1.2 Shkaqet materiale

- Gjykata e Shkallës së Parë, në vendimin e saj të marrjes së masës së sekuestros preventive, kishte detyrimin (siç edhe vetë parashtron se ka për detyrë, por që në fakt nuk e ka respektuar në vendimin objekt ankimi) që të tregonte dhe të analizonte në terma konkretë për rastin objekt gjykimi, të gjitha rrethanat faktike që ndikojnë në rëndimin apo zgjatjen e pasojave të veprës penale të dyshuar, ose lehtësimin e kryerjes së veprave të tjera penale potenciale, në mënyrë të tillë që marrja e masës së sekuestros preventive të jetë urgjente në raport me kohëzgjatjen e procedimit penal.

- Nga ana tjetër, Gjykata e Apelit dhe pse arsyeton në mënyrën formale, sërish ka gabuar dhe ka keqinterpretuar parashikimet e nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale dhe të drejtës penale materiale, lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sekuestros preventive, në raport me rastin objekt gjykimi.

- Nuk ka asnjë rrethanë faktike që të ketë mundësinë që potencialisht të ndikojë në rëndimin apo zgjatjen e pasojave të veprës penale të dyshuar, ose lehtësimin e kryerjes së veprave të tjera penale potenciale.

- Kështu, gabimi kryesor i Prokurorisë në Kërkesën që i ka paraqitur Gjykatës për caktimin e masës së sekuestros preventive mbi pronën me nr. 1/416, ndodhur në ZK 7642, volum 30, fq. 157 (referuar më poshtë si prona me nr. 696, sipas referimit edhe në Vendimin objekt Ankimi), ka të bëjë me faktin që ka marrë përsipër të vlerësojë operacionalitetin e bazës ndihmuese të Limionit, pa pasur kompetencën që të bëjë një vlerësim të tillë dhe pa iu referuar në asnjë moment nivelit të këtij operacionaliteti në terren, i cili vazhdon të mos ketë ndryshuar që nga data e Akt Marrëveshjes nr. 4389 prot., datë 10.12.2021, nënshkruar ndërmjet Komandës së Forcës Detare dhe Shoqërisë “Marina Bay Saranda” SHPK apo Procesverbalit i dorëzimit nr. 875/2 regj., datë 30.3.2022, bashkëlidhur të cilit janë edhe fotot e infrastrukturës, nga të cilat mund të kuptohet lehtësisht se ky operacionaliteti bazës është inekzistent dhe në këtë kuadër, Shoqëria “Marina Bay Saranda” ka marrë përsipër që të realizojë pikërisht urdhërimet e vetë Komandës së Forcës Detare për ndërtimin si të bankinës ashtu edhe të infrastrukturës mbështetëse në funksion dhe për qëllimin e vetëm të rikthimit në operacionalitet të kësaj baze.

- Nga ana tjetër, Gjykatat pranojnë dëshirën e Prokurorisë për të marrë rol aktiv, si një ushtarak i mirëfilltë, në interpretimin e Operacionalitetit të Bazës Ndihmuese të Limionit, edhe pse konkluzionet e saj mbi operacionalitetin e Forcës Detare nuk janë as rrjedhojë e ndonjë interpretimi ushtarak të taktikave ose nevojave që ka Forca Detare apo mbi bazën e të cilave ajo operon. Kujtojmë që organi i vetëm kompetent, ligjor, teknik e ushtarak që mund të bëjë përcaktimin e Operacionalitetit të një baze detare apo nevojës për një të tillë, është

vetëm Forca Detare dhe/apo Shtabi i Përgjithshëm, subjekte këto që kanë dhënë miratimet përkatëse, madje duke ndikuar e dirigjuar edhe se si do të duheshin bërë ndërhyrjet, pikërisht për ta bërë Operacionale këtë bazë ndihmuese, prej vitesh e abandonuar dhe tërësisht e rrënuar.

- Operacionaliteti i bazës nuk ka asnjë lidhje me ndonjë shkelje të prezumuar apo të dyshuar nga Prokuroria në ndonjë moment të procedurës administrative që ka konkluduar me daljen e VKM nr. 514, datë 1.7.2020, por duhet gjykuar në raport me rolin e Komandës së Forcës Detare dhe ekskluzivitetin e saj në gjykimin e vlerësimin e planeve operacionale dhe administrimin e Bazës. Në këtë kuadër, si shkresa e datës 18.06.2020 e Komandës së Forcës Detare, ashtu edhe Marrëveshja nr. 4389 prot. datë 10.12.2021, e amenduar me 4.3.2021, tregojnë qartë se nuk ka asnjë lloj delegimi të planeve operacionale apo lënien në diskrecion të Shoqërisë “Marina Bay Saranda” të administrimit të bazës dhe operacionalitetit të saj, por ka pasur dhe vazhdon të ketë administrim nga Komanda e Forcës Detare si në urdhërimet e saj për infrastrukturën që i duhet në bazë të planeve operacionale ashtu edhe në drejtim të aksesit të kufizuar thjesht në ndërtim të infrastrukturës të Shoqërisë “Marina Bay Saranda”, Prokuroria, edhe pse është e vetëdijshme se vullneti i Komandës së Forcës Detare dhe aprovimi i saj është i administruar shkresërisht dhe zyrtarisht (Shkresa e datës 18.06.2020), në paragrafin 39 të Vendimit të Gjykatës, bën një vlerësim tërësisht subjektiv të këtij vullneti të shprehur të Komandës së Forcës Detare, duke u marrë me 1 ditë diferencë që konstaton nga shkresa e datës 17 qershor 2020 e Shefit të Shtabit me datën 18 Qershor të shkresës zyrtare të Komandës së Forcës Detare. Në këtë moment procedural që ndodhet hetimi, pra në vlerësimin e Kërkesës së masës së sekuestros preventive, kjo ditë diferencë nuk ka asnjë lloj vlere rënduese të situatës, pasi do i përkasë themelit të gjyimit për të provuar nëse ka apo jo diferencë të një dite dhe kuptimi apo shkaku i saj, por ka rëndësi që ky vullnet miratues i Komandës së Forcës Detare ekziston dhe është i shprehur me shkrim zyrtarisht, pasi është një moment kyç që rrëzon një nga shkaqet e marrjes së masës së sekuestros, pra dukjes së gabuar sikur është mënjeluar Komanda e Forcës Detare dhe operacionaliteti i Bazës është lënë në vullnetin e Shoqërisë private.

- Gjykatat, në lidhje me vlerësimin për mënyrën e administrimit të bazës dhe planeve operacionale, si një rrezik për shkeljen e sigurisë kombëtare, duhet të vlerësonin pikërisht faktin se as edhe një veprim nuk është kryer në mungesë të vullnetit apo direktivave të Komandës së Forcës Detare, e cila është e vetmja që administron dhe garanton këto procese, madje edhe duke përcaktuar qartë dhe kufizuar aksesin e Shoqërisë “Marina Bay Saranda” SHPK sipas Akt Marrëveshjeve në vijim.

- Në të kundërt me sa konkludojnë Gjykatat, nga aktet dhe ligji rezulton qartazi se pasuria objekt i Kontratës së Qirasë dhe qoftë edhe ajo mbi të cilën është vendosur masa e sekuestros, janë dhënë në përputhje të plotë me ligjin dhe në përputhje të plotë të vullnetit të të gjithë funksionarëve publikë që kanë pasur kompetenca ligjore në procedurën përkatëse, duke filluar që nga Ish Shefi i Shtabit të Përgjithshëm z. Bardhyl Kollçaku, ish Ministria e Mbrojtjes, sot Ministre për Evropën dhe Punët e Jashtme Znj. Olta Xhaçka, Këshilli i Ministrave që ka disponuar me anë të VKM nr. 514, datë 1.7.2020, Komandanti i Forcës Detare dhe paradoksalisht edhe vetë Kallëzuesi në cilësinë e Zëvendës Komandantit të Forcës Detare si ushtrues i detyrës së Komandantit të Forcës Detare.

- Gjykata në vendimin objekt Rekursi, keqinterpreton edhe nenin 5.8 të Kontratës së Qirasë, në të cilin parashikohet se: “Qiramarrësi, në funksion të zhvillimit të aktivitetit dhe sipas kushteve të propozuara nga Ministria e Mbrojtjes dhe të marra përsipër nga Qiramarrësi duhet të ruhet gatishmëria dhe operacionaliteti nëpërmjet ndërtimit të një bankine të re dhe infrastrukture mbështetëse të saj, sipas standardeve të kërkuara”. Këtë parashikim kontraktor, Gjykatat e kanë keqinterpretuar dhe kanë vlerësuar se krijohet bindja

sikur ky operacionalitet dhe gatishmëri i është lënë në dorë investitorit, pasi nuk shihet që Ministria e Mbrojtjes të ketë paraqitur ndonjë standard tjetër veç projektit të grupit të punës të Komandës së Forcës Detare. Në fakt, arsyeja që në Kontratën e Qirasë nuk ka ndonjë standard të ri apo ndonjë projekt të përcaktuar është pikërisht sepse specifikimet e Bankinës dhe infrastrukturës mbështetëse të saj kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë kompetencë e Komandës së Forcës Detare, dhe kjo në fakt provon faktin që është vetëm Forca Detare që parashtron nevojat e infrastrukturës që duhet të ndërtohet dhe specifikimet përkatëse, në mënyrë të pavarur nga vullneti i ndonjë organi tjetër administrativ. Po kështu, nga ana e Prokurorisë pretendohet se vëllimet dhe sipërfaqet e infrastrukturës propozohen apo miratohen nga ana e Shoqërisë apo Ministrisë, kur në fakt propozimet dhe preventivat e punimeve kanë qenë gjithmonë të rakorduara ndërmjet Shoqërisë dhe vetë Forcës Detare, e cila ka dhënë edhe miratimin përkatës, duke nënshkruar Akt Marrëveshjen nr. 4389 prot., datë 10.12.2021 dhe amendimin nr. 1, me nr. 724 prot., datë 4.3.2022. Në këtë kuadër, vetë kronologjia e akteve dhe shkresave provon faktin që Komanda e Forcës Detare ka pasur dhe vazhdon të ketë të drejtën dhe detyrimin e përcaktimeve të Bankinës dhe infrastrukturës mbështetëse, dhe për ta sjellë në vëmendje të Gjykatës përmendim se kronologjia ka qenë e tillë: “- Shkresë e datës 18.06.2020 e Komandës së Forcës Detare ku shprehet vullneti i saj për miratimin e qiradhënies, ku përcakton si kusht detyrues ndërtimin e bankinës dhe infrastrukturës mbështetëse në kuadër të operacionalitetit të bazës dhe kjo datë shënon në fakt edhe përputhjen e vullneteve të të gjithë organeve të përfshira në këtë proces;

- Kontrata e Qirasë datë 16.07.2020 e nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Shoqërisë “Marina Bay Saranda” SHPK; Akt Marrëveshje nr. 4389 prot., datë 10.12.2021 “Për dhënien e aksesit për fillimin e punimeve për ndërtimin e objekteve në interes të Komandës së Forcës Detare dhe lejimin për kalimin e mjeteve dhe të personelit që do të punojë për ndërtimin e dallgëthyesit në pronat në administrim të Komandës së Forcës Detare, Gjiu i Limionit Sarandë”;

- Amendim nr. 1, me nr. 724 prot., datë 4.3.2022, i Akt Marrëveshjes nr. 4389 prot., datë 10.12.2021 “Për dhënien e aksesit për fillimin e punimeve për ndërtimin e objekteve në interes të Komandës së Forcës Detare dhe lejimin për kalimin e mjeteve dhe të personelit që do të punojë për ndërtimin e dallgëthyesit në pronat në administrim të Komandës së Forcës Detare, Gjiu i Limionit Sarandë”.

- Nga kronologjia e ngjarjeve dhe vetë përmbajtja e akteve që pasqyrojnë ato, të renditura më sipër, qartazi nuk ka asnjë lloj përcaktimi nga Ministria e Mbrojtjes, ajo e Financave apo e vetë Këshillit të Ministrave të detajeve të infrastrukturës apo operacionalitetit të Bazës, pasi ka qenë gjithmonë Komanda e Forcës Detare që fillimisht ka miratuar mundësinë e Qiradhënies, më pas ka urdhëruar edhe kushtet thelbësore pa të cilat kjo nuk do të ishte e mundur dhe nuk do të lejohej prej saj (në kuptimin që nuk do të merrte miratimin) dhe në fund nëpërmjet Akt-Marrëveshjeve me Shoqërinë “Marina Bay Saranda” SHPK ka diktuar çdo ndërtim infrastrukturor, volum dhe madje edhe formën e aksesit apo kushtëzimin e tij.

- Faktet e mësipërme dhe rolin determinant të Komandës së Forcës Detare e ka pasur të qartë Prokuroria, madje edhe vetë Kallëzuesi, por mbase e sugjestionuar nga ky i fundit bën një tjetër spekulim flagrant të përmbajtjes së akteve shkresore zyrtare (në faqen 44 të Vendimit objekt Ankimi), duke i servirur Gjykatës një fakt tërësisht të paqenë. Konkretisht, është keqinterpretuar vullneti i qartë i Komandës së Forcës Detare në shkresën e datës 18.06.2020 (nënshkruar nga vetë kallëzuesi, në cilësinë e zëvendës Komandantit të Forcës Detare), duke e interpretuar si një përgjigje negative të tij apo si një përgjigje që lidhej me “përtej sipërfaqes prej 7000-9000 m²”.

- Ky interpretim është sa i pabazuar aq edhe naiv, pasi vetë sipërfaqja e pronës nr. 696, siç edhe citohet në Vendimin objekt Ankimi, e parashtruar nga Prokuroria është prej 39,446 m² (sipërfaqe që Prokuroria e ka servirur në Kërkesë dhe Gjykata e parashtron në pikën 2 të Vendimit, si sipërfaqe e pronës nr. 696, të vendosur në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes së Forcës Detare, sipas të dhënave të marra nga Shtabi i Përgjithshëm). Në fakt, në atë shkresë që siç e thamë është nënshkruar nga vetë ai që tashmë paraqitet në cilësinë e Kallëzuesit, jepej miratim i plotë (pas atij jo shumë të qartë të dy ditëve më parë, pra të datës 16 Qershor 2020), me kushtin e vetëm që ai vlerësonte, atë të ndërtimit të bankinës dhe infrastrukturës mbështetëse, duke folur në këtë moment për volume punimesh dhe jo sipërfaqe tej asaj të plan Vendosjes, pasi në rast se do të flitej për ndonjë sipërfaqe që nuk është pjesë e planvendosjes nuk do të fliste për 7000-9000 m², por për 39.446 m² dhe mbi të gjitha në atë rast nuk do të ishte miratimi i tij determinant, pasi do të flitej thjesht dhe vetëm për pronën shtetërore të gjirit turistik dhe jo për sipërfaqen e administruar nga Komanda e Forcës Detare.

- Është për të ardhur keq që Prokuroria dhe tashmë edhe Gjykata bien pre e sugjestionimit të kallëzuesit, i cili për shkaqe të tija personale, të lidhura ndoshta edhe me “hakmarrjen” ndaj eprorëve direkte që i bën fajtorë për shkarkimin nga detyra që mbante në kohët për të cilat edhe është bërë kallëzimi, mundohet që ato shkaqe të shkarkimit nga detyra (pa asnjë lidhje me ndonjë nga ngjarjet e kallëzuara) t'i bëjë të duken sikur kanë qenë për ndonjë heroizëm personal në mbrojtje të sigurisë kombëtare e të tjera si këto. Në fakt, arsyet e inatit personal, tashmë kallëzuesi po përpigjet që t'i realizojë duke u konfunduar data e shkresa, madje duke injoruar edhe vetë vullnetin e tij kur ka qenë pjesë e vendimmarrjes, duke servirur tashmë fakte konfuze të cilat Prokuroria i keqkupton dhe Gjykata i miraton duke caktuar edhe masën e sekuestros preventive.

- Përsa më sipër, pretendimi i Prokurorisë i pranuar edhe nga Gjykata, për cenimin e sigurisë kombëtare nëpërmjet delegimit të kompetencave të operacionalitetit të bazës nga Komanda e Forcës Detare te Shoqëria “Marina Bay Saranda” SHPK, është një pretendim sa i pambështetur aq edhe absurd, pasi përmbajtja dhe kronologjia e ngjarjeve faktike dhe shkresave që pasqyrojnë këto ngjarje provon pikërisht të kundërtën, pra që ky proces ka qenë nga fillimi në fund me miratimin dhe diktimin e kushteve nga vetë organi kompetent për sigurimin e operacionalitetit të Bazës Ndihmuese, pra Komanda e Forcës Detare.

- Referuar akteve shkresore që edhe citohen në Vendimin e Gjykatës, por sidomos atyre që u cituan më sipër nga ana jonë dhe analizës logjike e juridike të rrethanave faktike dhe kronologjisë së ngjarjeve, jo vetëm që nuk ka asnjë mundësi që të rëndohet ndonjë pasojë e ndonjë veprë penale të dyshuar apo mundësinë për të ardhur të tjera vepra në të ardhmen, por nga ana tjetër as nuk është cenuar dhe as nuk ka mundësi potenciale që të cenohet operacionaliteti i Bazës Ndihmuese dhe për rrjedhojë siguria kombëtare që përmendet nga Gjykata në Vendimin e saj objekt Rekursi.

- Përveç sa më sipër, Interesi publik dhe vetë siguria kombëtare janë duke u rrezikuar pikërisht prej Vendimit të marrjes së masës së sekuestros dhe situatës faktike aktuale në pronën e sekuestruar.

- Operacionaliteti i kësaj Baze Ndihmuese që Prokuroria i referohet veç duke parë shkresa dhe Gjykata e merr të mirëqenë, është një operacionalitet imagjinar, për të cilin më tej krijohet një panoramë po aq e paqenë sikur një Shoqëri Private ka hyrë në një Bazë Ushtarake, ka marrë në dorëzim një infrastrukturë ushtarake ekzistuese moderne e model dhe tashmë po e prish për të përfutur prej saj e për ta përdorur si reort turistik.

- Panorama reale që pasqyron situatën faktike të “infrastrukturës” mbi të cilën Prokuroria sheh operacionalitet detar ushtarak që po e rrezikokërka Shoqëria “Marina Bay Saranda” SHPK shihet qartë në fotot që i janë bashkangjitur vetë Procesverbalit të

Dorëzimit, nga të cilat rezulton se operacionaliteti dhe infrastruktura mundeshin vetëm të ndërtoheshin e të përmirësoheshin nga ana e Shoqërisë dhe jo e kundërta. Në këtë kuadër, çdo miratim e akses nga Komanda e Forcës Detare ka qenë pikërisht për qëllimin e ndërtimit të infrastrukturës, sipas vlerësimit që vetë ajo i bën operacionalitetit të Bazës Ndihmuese dhe kjo kompetencë e saj nuk mundet kurrësesi të merret nga Prokuroria apo Gjykata, aq më pak kur nuk konstatohet ndonjë operacionalitet konkret, por veç referime shkresash që ndërtojnë një operacionalitet imagjinar.

- Gjykata ndonëse përmend parimin e proporcionalitetit që duhet të vlerësojë në momentin e shqyrtimit të mundësisë së vendosjes së një mase sekuestro preventive, operacionalitetin ushtarak të Forcës Detare apo Sigurinë Kombëtare, në fakt me Vendimarrjen e saj i ka vënë në rrezik serioz potencial operacionalitetin, sigurinë kombëtare dhe interesin publik në përgjithësi, pasi e ka lënë situatën në terren tërësisht jo operacionale dhe për më tepër që vetë administrimi nga Administratori i vendosur prej Gjykatës paradoksalisht po e “realizon” një proces të tillë nëpërmjet një force private të sigurisë, duke mos qenë nën administrimin e Forcës Detare e për pasojë duke cenuar rëndë sigurinë kombëtare. Lidhur me parimin e proporcionalitetit dhe interesit publik, Gjykatat në rastin konkret duhet të kishin parasysh rrethanat e mëposhtme:

- Nga vetë qëllimi i Kontratës së Qirasë dhe kushtet e saj, është i qartë elementi i interesit publik të investimeve të Shoqërisë, ku jo vetëm përse i përket infrastrukturës së Bazës Ndihmuese, por edhe në tërësi investimit turistik në sipërfaqen tej asaj të administruar nga Komanda e Forcës Detare, do të mbetet në pronësi shtetërore dhe nuk do të përfitohet nga Shoqëria, e cila ka veç qiramarrje të përkohshme dhe shfrytëzim të përkohshëm të infrastrukturës turistike, duke pasur detyrimin që ta kalojë në dorëzim të shtetit në përfundim të afatit të qirasë.

- Nga përmbajtja e Akt-Marrëveshjeve të nënshkruara ndërmjet Komandës së Forcës Detare dhe Shoqërisë “Marina Bay Saranda” SHPK shihet qartë që jo vetëm nuk ka pasur e vazhdon të mos ketë ndonjë qëllim apo rrezik potencial të cenimit të operacionalitetit të Bazës Ndihmuese, por përkundrazi ndërtimi i infrastrukturës në funksion të krijimit të këtij operacionalitetit që është thuar se inekzistent.

- Vlerësimi i Operacionalitetit të Bazës Ndihmuese dhe sigurisë kombëtare janë kompetenca të organeve specifike si Komanda e Forcës Detare, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe Ministria e Mbrojtjes, duke mos qenë e ligjshme dhe proporcionale ndërhyrja nga organe të tjera qoftë edhe Gjyqësore, të cilat mund të vlerësojnë veçse anën administrative të vendimarrjes, por kurrësesi aspektin e planit operacionel dhe të sigurisë kombëtare.

- Gjithashtu, po sjellim në vëmendje një fakt tjetër që ka ndodhur pas marrjes së Vendimit të caktimit të sekuestros preventive, objekt ankimi, ku Administratori i përcaktuar në Vendimin e Gjykatës, në mungesë tërësore të pranisë së forcave ushtarake nën përgjegjësinë apo jo direkte të Komandës Detare, ka caktuar për ruajtjen dhe administrimin e pronës së sekuestruar një forcë sigurie private. Do të mjaftonte vetëm ky fakt për të kuptuar pasojat që sjell vendimin gjyqësor për sekuestrimin e një prone që duhet të administrohet nga vetë organi Komanda e Forcës Detare dhe rreziku potencial që ka sjellë vendimarrja në drejtim të sigurisë kombëtare apo të operacionalitetit, që në fakt duhet të garantonte.

- Së fundmi, në lidhje me mungesën e elementit të urgjencës, siç e thamë edhe më sipër, kallëzimi që ka sjellë edhe regjistrimin e procedimit penal lidhur me këtë çështje është paraqitur 2 vite para se të kërkohej nga Prokuroria dhe të caktohej nga Gjykata masa e sekuestros preventive (në prill 2021 është regjistruar procedimi penal), duke qenë tërësisht i vendosur jashtë kontekstit kohor apo urgjencës në ardhje pasojash, rëndim të tyre apo qoftë edhe për vepra të tjera penale potenciale.

- Në këtë kuadër, nuk arrijmë të kuptojmë se si mundet që të konsiderohet si urgjente marrja e një mase sekuestrore preventive të pronës në fjalë me argumentet e urgjencës së parandalimit të ndonjë veprë penale apo të rëndimit të pasojave të saj (kur vetë vepra e kallëzuar, hetuar e dyshuar deri në këtë moment) rezulton ajo e shpërdorimit të detyrës, e cila potencialisht nuk ka ndonjë lidhje me vetë shkaqet e tjera të referuara si të operacionalitetit apo sigurisë kombëtare.

-Për të gjitha sa parashtruam dhe argumentuam më sipër, konkludojmë se vendimi nr. 9, datë 3.4.2023, i Gjykatës së Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, me anë të të cilit është lënë në fuqi (me korrigjim) vendimi nr. 91 datë 24.2.2023 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është marrë në mosrespektim dhe zbatim të gabuar të ligjit material e procedural, madje edhe në kundërshtim me vetë praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke pasur rëndësi për njësimin apo zhvillimin e praktikës gjyqësore.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal

96. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) konstaton se, rekursi është paraqitur në formën e kërkuar nga ligji dhe brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 435 të Kodit të Procedurës Penale (në vijim KPP). Organi i akuzës është njoftuar nëpërmjet aktit “Dëftesë komunikimi”.

97. Shkaqet e rekursit parashikohen në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale, i cili, në pikën 1 të tij, parashikon se: “1. Rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhet për këto shkaqe: a) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; b) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; c) kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.”.

98. Gjithashtu, në nenin 434, të KPP parashikohet se, “1. Gjykata e Lartë e shqyrton çështjen brenda kufijve të shkaqeve të ngritura në recurs. 2. Nëse rekursi pranohet për shqyrtim, Gjykata e Lartë ka të drejtë të vendosë edhe për çështje të ligjit që konstatohen kryesisht. ...”.

99. Kolegji, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosje dhe analizoi llojin e çështjes penale në gjykim, vendimet e gjykatave dhe shkaqet e rekursit, vlerëson se rekursi nuk arrin të cenojë vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta. Kolegji konstaton se shkaqet e rekursit kanë të bëjnë me vendimmarrjen e gjykatave të faktit, të cilat kanë disponuar pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe caktimin e masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventive” për pasurinë nr. 696, me sipërfaqe 39 446 m², me emërtimin “Baza Ndihmuese” Limion, Sarandë. Në shkaqet e rekursit, shoqëria rekursuese parashtron në thelb mungesën e arsytimit të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë; mungesën e dyshimit të arsyeshëm mbi ekzistencën e veprës penale, duke e lidhur me sigurimin e operacionalitetit të bazës detare, si dhe me mungesën e urgjencës për vendosjen e sekuestros mbi këtë pasuri. Rezulton se këto pretendime të palës së interesuar janë bërë objekt shqyrtimi gjyqësor edhe në gjykimin e zhvilluar në gjykatën e posaçme të apelit, e cila i ka trajtuar këto pretendime, duke u dhënë përgjigje të argumentuar.

100. Nga rrethanat e çështjes rezulton se sekuestrimi është vendosur në bazë të parashikimeve të nenit 274 të KPP, sipas të cilit: “1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron

sequestrimin e tij me vendim të arsyetuar. 2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal. 3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.”. Gjykatat e faktit kanë evidentuar faktin se prokuroria ka regjistruar më datë 16.4.2021, procedimin penal nr. 108, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

101. Masa e sekuestros është një masë provizore, e marrë në kushtet e një dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova/ekzistencën e indicieve/të dhënave, pra me një standard provueshmërie më të ulët se ai përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, të domosdoshëm për gjykimin në themel të çështjes (që në këtë lloj tipologjie çështjes do të ishte konfiskimi), si dhe në kushtet e urgjencës, pra të ekzistencës së një rreziku real e potencial se disponimi i lirë i pasurive që lidhen me veprën penale, për të cilat kërkohet vënia e masës së sekuestros, mund të rëndojë ose zgjasë pasojat e veprës penale.

102. Në rastin konkret objekt shqyrtimi rezulton se Gjykata e Apelit, lidhur me dyshimin e arsyeshëm, të lidhur nga pala rekursuese me vlerësimin e operacionalitetit të bazës ndihmuese të Limionit, ka parashtruar një argumentim të detajuar e shterues, nga i cili Kolegji veçon, ndër të tjera: “Gjykata e Posaçme e Apelit arsyeton, në vijim, rreth dy momenteve që paraqesin rëndësi, si në kuadër të trajtimit të kushtit mbi ekzistencën e dyshimit për veprën penale “Shpërdorim detyrë”, gjithnjë brenda caqeve të nevojshme në fokus të kërkimit për marrjen e masës së sekuestros preventive, pra, të parashikimit të pikës 1 të nenit 274, pra për të mundësuar lidhjen e sendit të sekuestruar me veprën penale, por edhe në kuadër të shkaqeve të ankimit të ngritur. Konkretisht, së pari, nëse pronat e përfshira në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes mund të disponohen lirisht si pronat e tjera shtetërore, apo kanë një status më të veçantë dhe, së dyti, si përcaktohet operacionaliteti i pronave të përfshira në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes, në kushtet kur diskutohet dhënia me qira e pronave shtetërore të përfshira në këtë plan, në rrethanën kur shkaku i arsyetuar për caktimin e masës së sekuestros preventive, por dhe në kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, është rreziku i cenimit të gatishmërisë dhe operacionaliteti i Komandës së Forcës Detare, rreziku i sigurisë kombëtare, ardhur si pasojë e dhënies me qira të pronës nr. 696, pronë e gjendur në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes. Në vlerësim edhe të Gjykatës së Posaçme të Apelit, pronat e përfshira në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes nuk mund të jenë objekt material i kontratave të qirasë së pasurisë shtetërore, për sa kohë ato janë pjesë e këtij Plani. Për këtë kjo gjykatë i referohet ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe Autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Një ndër kompetencat e Presidentit të Republikës të përcaktuara në nenin 9, “Kompetencat e Presidentit të Republikës”, pika 1, shkronja “f”, e këtij ligji, është miratimi, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, i Planit të Vendosjes dhe Përhapjes së Forcave të Armatosura në kohë paqeje. Rëndësia e Planit të Vendosjes dhe Përhapjes ka gjetur trajtim edhe në vendimin nr. 10, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit (ndër të tjera). Plani i vendosjes dhe përhapjes së FA-ve, që u referohet dispozita ligjore konkrete, është aspekt organizativ i drejtimit të FA-ve me karakter strategjik. Gjykata vlerëson se Kushtetuta në nenin 169/1 është e qartë në rolin drejtues që i ka caktuar Presidentit, rol nga i cili ai nuk mund të përjashtohet, sidomos kur bëhet fjalë për aspekte të rëndësishme të drejtimit strategjik. Duke iu referuar këtij vendimit të Gjykatës Kushtetuese, plani i vendosjes dhe përhapjes së Forcave të Armatosura, që u referohet dispozita ligjore konkrete e analizuar nga Gjykata Kushtetuese, nenit 12/d i ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe Autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar nga kjo gjykatë, është aspekt organizativ i drejtimit të Forcave të Armatosura me karakter strategjik. Parë në këtë këndvështrim, prona të përfshira në planin e vendosjes dhe përhapjes

nuk janë pasuri që mund të trajtohen lirisht si pronat e tjera shtetërore për t'u dhënë me qira sipas VKM nr. 54/2014, por kanë një status të veçantë, pasi i shërbejnë sigurisë kombëtare të një vendi, ruajtjes së gatishmërisë dhe operacionalitetit të njësive apo reparteve të dislokuara në këto prona. Në ndryshim nga çfarë pretendon mbrojtësi i palës ankuese ndër shkaqet e ankimit se operacionaliteti i bazës është përcaktuar dhe vijon të përcaktohet edhe tani nga Forca Detare, e cila ka dhënë aprovimin për dhënien me qira dhe se vlerësimi i operacionalitetit nuk i përket Prokurorisë, por strukturave përkatëse ushtarake, kjo gjykatë arsyeton se, duke qenë që plani i vendosjes dhe përhapjes është aspekt organizativ i drejtimit të Forcave të Armatosura me karakter strategjik, operacionaliteti i pronave të vendosura në këtë plan kushtëzohet, pike se pari nga fakti i përfshirjes së pronës në këtë plan. Kjo, pasi drejtimi i Forcave të Armatosura nga Presidenti i Republikës, i cili miraton edhe planin e vendosjes dhe përhapjes, si aspekt organizativ i drejtimit me karakter strategjik, ndërthur shumë aspekte dhe ndër to edhe ato të natyrës operative, teknike ose thjesht administrative (paragrafi 25 i sipërcituar i vendimit të Gjykatës Kushtetuese). Për pasojë, çdo veprim për dhënien me qira të pasurive të përfshira në planin e vendosjes dhe përhapjes, një ndër to edhe pasuria nr. 696, duhet të paraprihet pikë së pari nga nxjerrja e pronës nga ky plan në përputhje me ligjin. ...

56.3. Shkaqet e ankimit: “Forca Detare zotëron dhe zbaton planet operationale dhe çdo proces të realizuar nën pronën në administrim të saj: ndërtimi i infrastrukturës është në funksion të krijimit të këtij operacionalitetit që është thuajse inekzistent”, gjenden nga ky kolegji të pabazuara. Në thelb këto pretendime lidhen me situatën në terren të Bazës Ndihmëse “Baza Ndihmëse Limion Sarandë” dhe kanë në fokusuar të dhënat teknike të objekteve të vendosura në këtë pronë, pa u parë aspak faktet në këndvështrimin e faktit se prona nr. 696 e quajtur “Baza Ndihmëse Limion Sarandë” gjendet në planin e vendosjes dhe përhapjes. Për sa kohë vijon të jetë në këtë plan, që përbën aspekt organizativ të drejtimit të Forcave të Armatosura me karakter strategjik, kjo përbën pengesë për t'u trajtuar si një pronë e zakonshme shtetërore. Prona të tilla më herët, nëpërmjet një Dekreti të Presidentit të Republikës, janë vlerësuar të lidhura me aspektin organizativ të drejtimit të FA, me karakter strategjik, për t'i shërbyer ruajtjes së gatishmërisë dhe operacionalitetit të forcës së dislokuara në të dhe, për këtë shkak, kanë dhe statusin e ndryshëm nga pronat shtetërore të zakonshme në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes. Të vlerësuarit e strukturave të ndryshme si Komanda e Forcës Detare, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe Ministria e Mbrojtjes (siç pretendohet në ankim), duke e zbritur në nivel teknik diskutimin mbi mundësinë dhe detyrimin e ruajtjes së operacionalitetit të Forcës Detare nga pala investitore dhe qiramarrëse, shoqëria “Marina Bay Saranda” SHPK, vlerësime këto të këtyre strukturave që kanë shërbyer edhe mbështetje për procedurat e konkretizuara në mënyrë fundore me dhënien e pronës me qira në zbatim të VKM nr. 54, të vitit 2014, nuk paraqesin asnjë vlerë juridike, për sa kohe prona nr. 696 vijon të jetë në planin e vendosjes dhe përhapjes. Ky plan ka një procedurë të posaçme të miratimit të rregulluar me ligjin nr. 64/2014, ligj i dalë në mbështetje edhe të nenit 169, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që parashikon se: “Kompetencat e Presidentit të Republikës si Komandanti Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe ato të Komandantit të Forcave të Armatosura dhe varësia e tyre nga organet kushtetuese, caktohen me ligj”. 56.4. Ky Kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit vlerëson se, megjithëse disa nga personat që tregojnë rrethana të hetimit janë shprehur se prona nr. 696 e vendosur në Planin e Vendosjes dhe Përhapjes, nuk mund të jepej e gjithë me qira, por vetëm pjesërisht dhe pasi të nxirrej nga plani i vendosjes dhe përhapjes, duke përbërë ky moment një aspekt ligjor, vlera e deklarimeve të personave që tregojnë rrethana të hetimit, nuk paraqet rëndësi thelbësore për të evidentuar faktin nëse pronat e planit të vendosjes dhe përhapjes mund ose jo të jepen me qira...

103. Referuar këtyre argumenteve, si dhe rrethanave të çështjes të evidentuara nga gjykatat e faktit, Kolegji çmon se janë dhënë mjaftueshëm argumente në mbështetje të ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm për ekzistencën e veprës penale lidhur me procedurën e zhvilluar nga autoritetet me palën e interesuar Marina Bay Saranda SHPK, pa u konfunduar siç pretendohet me procedurën koncesionare që intereson subjektet e tjera.

104. Më tej, lidhur me kushtin tjetër të kërkuar për sekuestrimin, që është rreziku për dëm nga vonesa, Gjykata e Apelit ka arsyetuar se: *“Duket që Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë e ka arsyetuar vendimin duke e parë rrezikun e disponimit të lirë të pasurisë mbi të cilën ka vendosur sekuestros preventive në dy këndvështrime: “mund të lehtësojë apo të zgjasë pasojat e veprës penale apo të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale” dhe “vendosja e masës së sekuestrimit parandalon rrezikun e shitjes, së tjetërsimit apo humbjes së pasurisë që mund të konfiskohet”. Ky kolegji vlerëson se, rrethana që shërben në këtë situatë faktesh për vendosjen e masës së sekuestros preventive është mundësia që përdorimi apo aksesimi i pronës nga pala ankuese mund të lehtësojë apo të zgjasë pasojat e veprës penale, por nuk përjashtohet as mundësia që të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale. Theksohet se Prokuroria e Posaçme ka arsyetuar “që pjesa e bazës ushtarake do të kthehet në një kantier ndërtimi derisa të behet fshati turistik dhe në parashitjes së dhënë gjatë gjyqimit në apel u shpreh: “punimet për investim në fushën e turizmit dhe ndërtimi i Portit Turistik janë në fillim e sipër”. Këtë linjë e ka pranuar me të drejtë edhe Gjykata e Shkallës së Parë, kur është shprehur se duhet vendosur sekuestro preventive për të mundësuar ndërprerjen dhe kryerjen e veprimeve të investimit në fushën e turizmit apo edhe ndërtime të tjera nga investitori në këtë pronë, pasi cenohet gatishmëria dhe operacionaliteti i Komandës së Forcës Detare, pikërisht mbi pronën nr. 696, pronë e vendosur në plan vendosje dhe përhapje, duke vënë në rrezik sigurinë kombëtare.*

57.1. Te pretenduarit ndër shkaqet e ankimit të faktit se prona është në disponim dhe administrim të Forcës Detare, bie ndesh me provat, pasi në këtë rast është e qartë se mbi pronën në fjalë janë ndërmarrë veprime konkrete, të cilat në vetvete, megjithëse duken të harmonizuara me procesverbale të mbajtur edhe me përfaqësues të Forcave të Armatosura, i lejojnë kompanisë ankuese qiramarrëse të kryejë veprime dhe të ketë akses në përmbushje të planit të investimit mbi këtë pronë. Është fakt që, nëpërmjet dhënies me qira sipas kontratës së lidhur midis palëve me datë 16.7.2020, parashikohet se subjekti privat, pra, pala ankuese, do të pajiset me leje ndërtimi dhe shfrytëzimi të objekteve turistike, që parashikohet të ndërtohen brenda territorit të bazës detare, veprime këto që cenojnë sigurinë kombëtare, duke qenë se kjo pronë (prona nr. 696) me Dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë është brenda planit të vendosjes dhe përhapjes së forcave të armatosura dhe funksioni i saj specifik është për mbrojtjen kombëtare, e përcaktuar si e tillë nëpërmjet një procedure të posaçme sipas ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe Autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” ...

58.1. Në këtë aspekt, në ndryshim nga çfarë pretendon ndër shkaqet e ankimit pala ankuese, prona nr. 696 në pronësi të shtetit vendoset nën sekuestron preventive, në kushtet kur vlerësohet se të ushtruarit e tagrave të buruara nga kontrata e qirasë nga kjo palë mbi këtë pronë të përfshirë në planin e vendosjes dhe përhapjes, do të rëndonte pasojat e veprës penale dhe do të shtonte rrezikun mbi gatishmërinë dhe operacionalitetin e Komandës së Forcës Detare, duke vënë në rrezik vazhdues interesat kombëtare të Sigurisë së Republikës së Shqipërisë, në vështrim të Kreut III, të VKM-së nr. 628, date 25.9.2019, “Për miratimin e dokumentit të rishikimit të strategjisë të mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë”, përsa kohë pala qiramarrëse/investitore ka akses në përdorimin e pronës në fjalë.

105. Referuar këtij argumentimi, Kolegji vlerëson se është i bazuar edhe konkluzioni që ka të bëjë me ekzistencën e rrezikut që vjen nga disponimi i lirë i pronës shtetërore, i

dhënë me qira. Në këtë mënyrë, ka arsye të bazuara të mendohet se disponimi i lirë i pronës mund të ndikojë në shtimin e rrezikut mbi gatishmërinë dhe operacionalitetin e Komandës së Forcës Detare, duke vënë në rrezik vazhdues interesat kombëtare të Sigurisë së Republikës së Shqipërisë, në vështirësi të Kreut III, të VKM nr. 628, date 25.9.2019, “Për miratimin e dokumentit të rishikimit të strategjisë të mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë”, përsa kohë pala qiramarrëse/investitore ka akses në përdorimin e pronës në fjalë.

106. Pra, konstatohet se nga gjykatat e faktit është evidentuar ekzistenca e të dy kushteve të parashikuara nga neni 274, pika 1, i KPP, të nevojshëm për vendosjen e masës së sigurimit me karakter pasuror, sekuestrimi i pasurive. Në këtë vazhdë, nuk rezulton që edhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë të mos ketë dhënë argumente, edhe pse në mënyrë koncize dhe të përmbledhur, si dhe të kombinuar me parashtrimin e detajuar të rrethanave të çështjes, lidhur me ekzistencën e të dy kushteve të parashikuara nga neni 274, pika 1, i KPP, argumente të dhënë gjithësesi në mënyrë më të detajuar dhe shteruese nga gjykata e posaçme e apelit.

107. Në përfundim, referuar të gjitha shkaqeve të ngritura në rekursin paraqitur për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, Kolegji vlerëson se lidhur me këto shkaqe dhe për këtë palë, vendimarrja e gjykatave të faktit mbetet e pacenueshme. Rezulton se nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, në dëm të palës rekursuese, si dhe nuk rezulton që vendimi i ankimuar të vijë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, nuk konstatohet asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 432 i KPP.

108. Përtej rastit të vënë për shqyrtim përpara Gjykatës së Lartë, pra cenimit të pretenduar të paligjshëm të interesave të palës rekursuese, pretendime për të cilat është arsyetuar më lart se nuk janë të bazuar, Kolegji çmon të sjellë në vëmendje të organeve proceduese që të mbajnë në konsideratë faktin se administrimi i pronës duhet të mbajë të paprekur funksionin e bazës detare ndihmëse të Limianit Sarandë dhe t’u sigurojë forcave detare operacionalitetin e nevojshëm në funksion të kryerjes së detyrave, që atyre u ka ngarkuar Kushtetuta dhe ligji, në mbrojtje të Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 433 dhe 441, pika 1, shkronja “a”, të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S I :

Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e interesuar Marina Bay Saranda SHPK, ndaj vendimit nr. 09, datë 03.04.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më 15.06.2023